



Multidisciplinary Research Journal "Olcinium"
Multidisciplinarni Istraživački Časopis "Olcinium"
Revista Kërkimore Multidisciplinare "Olcinium"

SOCIAL SCIENCES SESSION

ISSN 2261-2674 (Online)

Volume 12. Nr. 1 (2023): APRIL

www.olcinium.me

NEWSROOM BOARD

Prof.Dr.Diana Shehu

Agricultural University of Tirana, Faculty of Economy & Agribusiness, Tirana/Albania

Prof. Dr. Piotr Pietrzak

Sofia University “St. Kliment Ohridiski”, Bulgaria

Academician PhD Slobodan Nešković

University Business Academy in Novi Sad, FIMEK;

Prof. Dr. Tibbor Petres

Department of Statistics, Faculty of Economics of the University of Szeged, Hungary

Prof. Dr. Sonia Vitanova Srezova

Department of Foreign Languages, English Branch “Ss. Kliment Ohridski” University, North Macedonia

Editor of the Scientific Magazine MA.

Mr. Artan Osmanović

Publishing house:

Euro Project –Montenegro

SCIENTIFIC COMMITTEE

- Prof. Dr. Konstantin Pochivalov, (Russia)
- Prof. Dr. Nevenka Žarkić-Joksimović, (Serbia)
- Prof. Dr. Slađana Benković FON (Serbia)
- Prof. Dr. Dragoljub Jankovic (Montenegro)
- Prof. Dr. Anatoly Avdenko (Ukraine)
- Prof. Dr. Valentin Nedeff (Romania)
- Prof. Dr. Constantin Bungau (Romania)
- Prof. Dr. Vladimir P. Sergienko (Belorus)
- Prof. Dr. Predrag Dašić (USA)
- Prof. Dr. Hidajet Shehu (Albania)
- Prof. Dr. Laszlo Karpati (Hungary)
- Prof. Dr. Akhter Alham (India)
- Prof. Dr. Brilanda Bushati (Albania)
- Prof. Dr. Seadin Xhaferi (Macedonia)
- Prof. Dr. Astrit Mehmeti (USA)
- Prof. Dr. Kerstin Bree Carlson (Danska)
- Prof. Dr. Robert Dimitrejski (Macedonia)
- Prof. Dr. Michael Minch (USA)
- Prof. Dr. Muharem Karamujić (Bosnia and Herzegovina)
- Prof. Dr. Arben Malaj (Albania)
- Prof. Asc. Dr. Blerta Dragusha (Albania)
- Prof. Dr. Niké Wentholt (Netherland)
- Prof. Dr. Drita Kruja (Albania)
- Prof. Dr. Laszlo Karpati (Hungary)
- Prof. Dr. Miodrag Brzaković (Serbia)
- Prof. Asc. Dr. Darko Lacmanović (MNE)
- Prof. Dr. Salvator Bushati (Albania)

- Prof. Dr. Sofronija Miladinovski (Macedonia)
- Prof. Dr. Daniel Dobrev, (Bulgaria)
- Prof. Dr. Sampurna Mehta (India)
- Prof. Dr. Heinrich Meister (Switzerland)
- Prof. Dr. Jusuf Mustafai (Macedonia)
- Prof. Dr. Radovan Stojanović (MNE)
- Prof. Dr. Biljana Ciglovska (Macedonia)
- Prof. Dr. Artan Nimani (Kosovo)

Contents

UDHËHEQJA SI FUNKSION I MENAXHMENTIT, LLOJET DHE SISTEMET E UDHËHEQJES ORGANIZATIVE.....	7
Prof. Ass. Dr. Fari Bushi.....	7
ROLI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË SISTEMIN BANKAR.....	16
MSc. Inxh. Hasan MLINAKU	16
Bashkëautor: Prof. Ass. Dr. Besnik HAJDARI	16
EDUCATION IN FUNCTION OF THE LABOR MARKET AND THE ECONOMY: ANALYSIS OF STUDY PROGRAMS OF HIGHER EDUCATION FROM THE PERSPECTIVE OF UHZ	25
Prof.ass.dr. Driton Sylqa ¹	25
Prof.asoc.Theranda Beqiri ²	25
UTICAJ INFLACIJE NA PRODUBLJIVANJE KRIZE U ZEMLJAMA ZAPADNOG BALKANA	38
Prof. dr. Husnija Bibuljica ¹ ,.....	38
Msc. Haris Bibuljica ²	38
STRUKTURA LIGJORE E “SHPËRLARJES SË PARAVE DHE KONTRIBUTEVE TJERA NGA VEPRA PENALE E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT” E PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE SI VEPËR PENALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË VERIORE	49
Dr. sc. Mitasin Beqiri.....	49
AFTËSITË TEKNIKE DHE NDËRPERSONALE NË APLIKIMIN E SISTEMEVE TË INOVACIONIT TEK BIZNESET ELEKTRONIKE.....	54
Autor: Prof. Ass. Dr. Hazir HAJDARI	54
& Prof. Ass. Dr. Besnik HAJDARI	54
THE BANKING SECTOR AND PAYMENT SERVICES AS A FACTOR IN THE COMPANY’S SUCCESS.....	64
BANKARSKI SEKTOR I USLUGE PLAĆANJA KAO FAKTOR USPJEŠNOSTI PREDUZEĆA	64
Prof.ass.dr.Hajrija Skrijelj ¹ , Dr.sc.Sami Mazreku ² , Dr.sc.Duda Balje ³	64
TOURISM AND CURRENT TRENDS IN THE TOURIST MARKET	79
TURIZAM I AKTUELNI TRENDIVI NA TURISTIČKOM TRŽIŠTU	79
Prof.ass.dr.Hajrija Škrijelj ¹ , Prof.ass.dr.Anela Džogović ²	79
UPRAVLJANJE KRIZOM.....	93
Prof.dr Mirsad Nuković ¹ , dipl.ing. Hido Ljajić ² ,.....	93
Doc.dr Edib Hajrović ¹ ,.....	93
Msc Ismet Suljović ³	93
THE DILEMMA OF COMMERCIAL DUALISM IN KOSOVO	97
Mustafë Kadriaj,Vehbi Ramaj Ylber Krasniqi.....	97
ECONOMIC DUALISM IN KOSOVO AS A REALITY OR A DILEMMA.....	108

Mustafë Kadriaj, Vehbi Ramaj Ylber Krasniqi.....	108
SCHOOL EDUCATION AND THE GREAT IMPORTANCE FOR THE PROTECTION, AWARENESS AND SUPPORT OF VIOLENCED CHILDREN.....	119
Msc. DORINA ARAPAJ MERDANI.....	119
MANAGEMENT MODEL IN TOURISM IN THE FUNCTION OF TOURISM BUSINESS.....	135
Doc. Dr Nedžad Azemović,	135
Dr. Rešad Azemović,	135

UDHËHEQJA SI FUNKSION I MENAXHMENTIT, LLOJET DHE SISTEMET E UDHËHEQJES ORGANIZATIVE

Prof. Ass. Dr. Fari Bushi
Universiteti i Shkencave të Aplikuara –Ferizaj

Abstract

Leadership is an important management function that helps maximize efficiency and achieve organizational goals. It is the creation of a vision for the organization where it presents the future, desirable state, orienting what the members of the organization must do to achieve it. While an organization may have people with different talents and abilities within it, the leader is the one who uses individual efforts towards the general, i.e. collective, goal. The leader ensures that each team member understands their roles and provides the right environment to help them perform at their best. The growing importance of intelligent leadership models has encouraged organizations to hire leaders with diverse skills that provide a competitive advantage and increase organizational efficiency and productivity. The leader is the one who encourages the team, inspires them to act and helps the employees to realize their potential. To be a successful leader, he must possess the qualities of foresight, drive, initiative, self-confidence and personal integrity.

Fjalet kyqe: *udhëheqje, menaxhim, vizion, efikasitet, sukses, performim, funksion, motivim, ndryshim, organizim.*

Hyrje

Udhëheqja është një nga funksionet më të rëndësishme të menaxhmentit. Ajo i referohet aftësisë së një individi për të ndikuar tek të tjerët në arritjen e një qëllimi të përbashkët. Udhëheqja ka të bëjë me përafrimin e njerëzve me vizionin, frymëzimin e tyre dhe sigurimin e komunikimit efektiv¹. Çdo organizatë ka nevojë për udhëheqës.

Qëllimi i udhëheqësit është mbajtja dhe shtimi i efikasitetit të funksionimit të organizatës që udhëhiqet, ndaj edhe nëse organizata i ka të gjitha pozicionet favorizuese, përkatësisht avantazhet si burimet financiare, pozicionin e mirë në treg, teknologji moderne etj. nëse udhëheqja nuk është në nivelin e duhur, ajo dështon. Udhëheqja është një qëndrim, një prije dhe një mënyrë për t'iu qasur sfidave me të cilat përballemi çdo ditë.² Udhëheqësit janë ata që zbatojnë strategji dhe mënyra për të arritur qëllimet duke marrë mbështetje nga pasuesit.

Nga kjo mund të thuhet se udhëheqja ka ndikim jashtëzakonisht të madh në sjelljen dhe cilësinë e jetës së njeriut dhe kjo mund të vërtetohet edhe nga fakti se çdo ditë jemi dëshmitarë të organizatave, komuniteteve që ndryshojnë si rezultat i udhëheqësve, përkatësisht liderëve dhe pasuesve që së bashku realizojnë procesin e udhëheqjes. Shikuar historikisht duke filluar nga Aristoteli, Makiaveli e të tjerë kanë studiuar dhe diskutuar çështjen e udhëheqësit, përkatësisht liderit si një person i cili ndikon te individët, apo grupet, duke i ndihmuar dhe orientuar në arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

¹ Darryl Plecas, Colette Squires, Len Garis” The Essentials of Leadership in Government” City of Surrey, 2018, fq.11

² Dov Seidman” How We Do Anything Means Everything.. in Business” New Jersey 2007, fq.270

Shumë autorë janë përpjekur ta definojnë konceptin e udhëheqjes si: Udhëheqja është funksion i cili del a buron nga pozita në procesin e punës, ku numri më i madh i të punësuarëve i kryen punët ekzekutive, kurse numri më i vogël i tyre kryen punët e planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit, pra punet udhëheqëse³.

Udhëheqja është një proces dinamik i punës në grupe, ku individi në një periudhë të caktuar, në një kontekst të caktuar organizativ, ndikon në anëtarët tjerë të grupit të tyre të anagazhohen vetë për arritjen e qëllimeve dhe detyrave të grupit⁴.

Udhëheqja dhe menaxhimi janë dy nocione që përdoren shpesh, megjithatë këto dy fjalë në fakt paraqesin dy koncepte të ndryshme. Nocioni udhëheqës paraqet një person i cili ndikon në një grup të njerëzve drejt arritjes së një qëllimi, ndërsa nocioni menaxher paraqet personin përgjegjës për planifikimin dhe drejtimin e punës së një grupi individësh, monitorimin e punës së tyre dhe marrjen e masave korigjuese nëse është e nevojshme. Udhëheqësit dhe menaxherët pra dallojnë ngase përdorin udhëheqësit fokusohen në njerëz, inspirojnë, ndikojnë e motivojnë tek ata, menaxherët fokusohen në gjëra, përkatësisht planifikojnë, organizojnë, drejtojnë e kontrollojnë ato gjëra.

Llojet e Udhëheqjes

Me rritjen e numrit të ndihmësve, ndryshon jo vetëm kompetenca e udhëheqësit, por edhe metoda; udhëheqja kalon gradualisht nga udhëheqja autokratike në atë demokratike⁵. Në lëmin e organizatave, rrallë ka receta që u përshtaten të gjitha vendeve të punës, kompanive dhe ekipeve. Kultura e kompanisë, objektivat e ndjekura ose personaliteti i punonjësve, përcaktojnë se cili stil ose lloj i përshtatet më së miri kompanisë. Meqenëse qëllimi është krijimi i një kulture dhe vizioni që motivon dhe udhëheq suksesin e një ekipi dhe organizate, shikimi i stilit më të mirë të udhëheqjes për punën është kritike për suksesin e vazhdueshëm, krijimin e një avantazhi konkurrues dhe të qenit një udhëheqës më efektiv.

Duke punuar për të arritur motivimin e të tjerëve, inovuar dhe frymëzuar ndryshimin, një udhëheqës mund të përfshijë elemente të ndryshme të llojeve të udhëheqjes në varësi të situatës. Stili i udhëheqësit kuptohet si një sistem metodash që drejtuesi i përdorë kur bashkëvepron me vartësit. Drejtuesit e kompanive të mëdha dhe të vogla gjithmonë kërkojnë mënyrë për të komunikuar më mirë me punonjësit e tyre. Mc Daniel shkruan “Mënyra se si udhëheqësit marrin vendime, motivojnë ndjekësit, menaxhojnë ndryshimet, marrin iniciativa dhe trajtojnë krizat, përcaktohet nga stili i tyre i udhëheqjes”.

Kuadri i lidershit përshkruan një qasje se si komunikoni, si punoni, si i trajtoni të tjerët, si merrni vendime, si ndërveproni në treg dhe si mund të veproni në mënyrë të qëndrueshme⁶.

Të flitet për stilet e udhëheqjes do të thotë të depërtohet në një lëmi shumë të ndërlikuar dhe multidisiplinare, sepse ka të bëjë së pari me vetë natyrën e njeriut, e në rastin konkret me udhëheqësin, me strukturën e personalitetit të tij,

³ Prof.Dr.Ibrahim Kuka: Vendasja Afariste, Prishtinë, 1997. Fq.14

⁴ Dr. Kiril Postolov, Dr Lubomir Drakulevski “Organizimi” Shkup, 2010, fq.74

⁵ Grup autorësh “ Organizimi i punës” Prishtinë 1984, fq.186.

⁶ Dov Seidman” Why How We Do Anything Means Everithing in Business” New Jersey 2007, fq.271

me dëshirat, vullnetin, ambiciet dhe karakterin e tij. Stilet e udhëheqjes nuk kanë të bëjnë vetëm me udhëheqjen me njerëzit, por gjithashtu edhe me planifikimin, organizimin dhe vlerësimin e rezultateve të arritura. Kështu nuk është e rastit që sukseset i atribuohen udhëheqësit, sepse pikërisht nga ai varet zhvillimi dhe rritja e organizatës, mënyra se si i zotëron shkathtësitë, si shkathtësitë e komunikimit, shkathtësitë e shprehjes verbale, kontrollimin e pjesës joverbale të komunikimit etj.

Udhëheqja është një fenomen kompleks. Gjatë shekullit të kaluar, shumë studiues e studiuuan atë nga këndvështrime të ndryshme duke u përpjekur të formalizojnë llojet konceptuale të stileve të udhëheqjes. Në teori e sidomos në praktikën shkollore janë të njohura shumë stile të udhëheqjes. Këto stile në mes veti diferencohen me karakteristika të shumta. Pikënisje për përcaktimin e stilit të udhëheqjes mund të jenë:

- cilësitë e udhëheqësit,
- raporti ndaj bashkëpunëtorëve,
- shfrytëzimi i pozitës dhe i fuqisë që i është dhënë,
- raporti i tij ndaj detyrave që duhet t'i realizojë, etj.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të udhëheqjes në mejdisin e punës dhe secili prej tyre ka avantazhet dhe disavantazhet e tij, por ne do t'i paraqesim disa prej tyre.

Udhëheqja autokratike

Është një lloj udhëheqje në të cilën udhëheqësi kryesor është përgjegjës për marrjen e secilit prej vendimeve. Lideri i stilit autokratik karakterizohet me forma ekstreme individuale të vendimmarrjes⁷. Në këtë lloj udhëheqje, ekipi i punës mund t'u bindet vetëm udhëzimeve të vendosura nga udhëheqësi, në mënyrë që ata të mos mund të kontribuojnë nga ana e tyre asgjë, përveç përmbushjes së punës që u është besuar atyre, përkatësisht t'u permbahen udhëzimeve të udhëheqësit, t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë urdhërat e marra.

Udhëheqja autokratike mund të jetë efektive në rast se përballemi me një lloj pune në të cilën duhet të marrim shumë vendime dhe shumë shpejt dhe meqë udhëheqësi ka pozitë superiore, që ia rritë fuqinë, ai mund të ndikojë në kryerjen efikase të detyrave dhe me kohë. Kjo udhëheqje ka edhe aspekte negative siç është fakti që punëtorët nuk mund të shprehin idetë e tyre, pra u mungon kreativiteti, inovacioni, dhe komunikimi i dyanshëm i të punësuarëve dhe udhëheqësve.

Udhëheqja autokratike përdoret zakonisht kur ka pak hapësirë për gabime në kryerjen e detyrave të tilla si në punë që janë të rrezikshme ose kërkojnë një shkallë të lartë të sigurisë. Kur punonjësit nuk janë të sigurtë në aftësitë e tyre, ata kanë më shumë gjasa të tërhiqen nga udhëheqësit autokratik dhe e kundërta, kur punonjësit janë të sigurtë për rolin e tyre në organizatë dhe kanë një ndjenjë të lartë identiteti, ata janë më mbështetës për një udhëheqës jo autokratik.

⁷ Mr.Sc. Belul Beqaj” Liderशिpi” Prishtinë 2016, fq.78

Një drejtues autokrat ruan pushtetin, merr vendime të njëanshme dhe mbikqyrë nga afër aktivitetet e punëtorëve. Udhëheqja autokratike përfshin kontroll absolut autoritar mbi një grup. Siç e kemi shprehur më lartë udhëheqja autokratike mund të dëmtojë moralin e grupit në disa raste, pasi anëtarët e grupit mund të ndjehen të injoruar ose të refuzuar.

Udhëheqja autokratike mund të përdoret në mënyrë efektive në situatat kur lideri është anëtari më i ditur i grupit ose ka qasje në informacione që anëtarët e tjerë të grupit nuk e bëjnë.

Udhëheqja demokratike

Ky lloj i udhëheqjes karakterizohet nga krijimi i entuziazmit tek punëtorët duke i dhënë përparësi pjesëmarrjes së të gjithë grupit dhe jo rastësisht këtë udhëheqje edhe e atribuojnë udhëheqje pjesëmarrëse. Udhëheqja e ndan pushtetin e vet vendimmarrës me vartësit, duke i lejuar secilit anëtar të grupit të ketë mundësi të thotë mendimin e vet dhe të respektohet në vendimmarrje⁸.

Udhëheqja demokratike është një lloj shumë i hapur lidhshipi që përfshin anëtarët e grupit në procesin e vendimmarrjes.

Kjo lloj udhëheqje inkurajon çdo anëtar të ekipit të marrë pjesë në bisedë, të ndaj mendimet e tyre dhe të diskutojë hapur. Udhëheqesi do të përpiqet të dëgjojë të gjitha këto ide dhe do të marrë vendimin e tij në lidhje me mënyrën e veprimit. Në këtë lloj udhëheqje është e nevojshme që pjesëmarrësit e grupit t'i besojnë njëri-tjetrit, por edhe udhëheqësit, ndaj udhëheqësi duhet të krijojë marrdhënie dhe atmosferë besimi midis vartësve, por edhe për të, të krijohet një besim si një person që meriton respekt. Në këtë kontekst, për të krijuar këtë gjendje, udhëheqësi duhet të dëgjojë idetë e të tjerëve qoftë edhe në kundërshtim me idetë e veta, pa i gjykuar ato, gjë që anëtarët e ekipit kur e kuptojnë se mendimet e tyre po merren parasysh, ato zakonisht ndihen më të gatshëm të punojnë dhe bëjnë çmos për të dhënë rezultate pozitive.

Stili i udhëheqjes demokratike është shumë efektiv pasi inkurajon kontribute cilësore nga punonjësit. Ai prodhon një shpirt bashkëpunues që motivon ekipin dhe përmirëson moralin e grupit, gjë që nxitë produktivitet më të lartë.

Në anën tjetër udhëheqja demokratike ka edhe disa disavantazhe, bie fjala kur puna kërkon vendime të shpejta, ndërsa udhëheqja demokratike kërkon kontributin e të gjithëve në vendimmarrje, i bënë sfiduese vendimet. Pastaj duke dëgjuar vendimet e të gjithëve mund të merren vendime të gabuara, pasi ka të tillë që nuk janë ekspert në fushën që kërkohet.

Udhëheqja delektive “Laissez-Faire”

Është një lloj udhëheqje që përdoret me punonjësit që kanë përvojë dhe motiv të madh, kështu që nevoja për mbikqyrje zvogëlohet ndjeshëm duke marrë vendime në mënyrë korrekte, pa pasur nevojë që lideri t'i përcjellë gjatë gjithë kohës. Stili liberal mbështetet në një përdorim mjaft të kufizuar të pushtetit duke u lënë vartësve një shkallë të madhe lirie në veprimtarinë e tyre.⁹

⁸ Prof. as.dr. Mimoza Kasimati, Prof.as.dr Mimoza Manxhari, “Sjellje Organizative” Tiranë 2005. fq.315

⁹ Prof. Dr. Berim Ramosaj ”Leadership” Pejë 2017, fq.119

Udhëheqja laissez-faire merr një qasje praktike ndaj udhëheqjes dhe u jep vartësve lirinë për të marrë vendime. Kështu gjersa udhëheqësit u sigurojnë ekipeve burimet dhe mjetet e nevojshme për të pasur sukses, ata mbeten të papërfshirë në punën e përditshme. Nëse lidhshipi autoritar ka të bëjë me kontroll të plotë dhe rregulla të rrepta, udhëheqja laissez-faire është e kundërta e saj.

Udhëheqësit laissez-faire lënë shumë përgjegjësi në duar të punëtorëve, por ato janë të kujdesshëm në drejtimin e ekipit, pasi kërkojnë punëtorët më të mirë, me përvojë, të specializuar në detyrat e caktuara etj. Kjo lloj udhëheqje ka përparësitë dhe disavantazhet e veta. Çdo punonjës është përgjegjës për punën dhe performancën e tij dhe duke marrë përgjegjësinë për detyrat e tyre të caktuara, ata bëjnë çmos për të arritur qëllimet e tyre.

Udhëheqja liberale krijon ambient ideal për krijuesit duke iu dhënë hapësirë punonjësve të mendojnë në mënyrë kreative për t'i kryer detyrat në mënyrë efikase me lirinë për të punuar në mënyrë të pavarur, pastaj autonomia që mund t'u ipet anëtarëve të grupit, bënë që ata të ndihen të kënaqur dhe të motivuar në punën e tyre.

Në anën tjetër, udhëheqja liberale ka edhe anët e veta negative, bie fjala në disa situata ndihet mungesa e vetëdijes së rolit, pra anëtarët e grupit nuk e dinë rolin e tyre në grup, përkatësisht nuk janë të sigurtë se ç'rol kanë dhe çfarë duhet të bëjnë, pastaj disa udhëheqës nga ky stil përfitojnë në rastet kur nuk arrihen qëllimet, ata shmangin përgjegjësinë personale për dështimet e grupit, duke fajësuar anëtarët e grupit për moskryerjen e detyrave. Ka raste kur udhëheqësit e laissez-faire shihen të papërfshirë dhe të terhequr, gjë që te ithtarët mund të ndikojë që të mos kenë kujdes dhe shqetësim për projektin.

Udhëheqja transformuese

Është një stil udhëheqës që mund të frymëzojë ndryshime pozitive në ata që e djekin. Drejtuesit vendosin komunikim të plotë dhe marrin pjesë në aktivitet me synimin për të transmetuar tek punonjësit mënyrën e të parit se si duhet të zhvillohet projekti.

Udhëheqësit transformues frymëzojnë anëtarët e ekipit të tyre sepse ata presin më të mirën nga të gjithë dhe ata mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre¹⁰.

Udhëheqësit transformues mbajnë linjat e komunikimit të hapura në mënyrë që ndjekësit të ndjehen të lirë, t'i ndajnë idetë me udhëheqësit duke krijuar te ndjekësit besimin dhe respektin deri në atë shkallë sa mishërojnë idealet e tij ose te saj dhe i imitojnë këta individ.

Fokusi i udhëheqësit transformues është i drejtuar drejt organizatës dhe sjellja e tij ndërton përkushtimin e ndjekësve drejt objektivave organizative, përkatësisht ndikon tek anëtarët e grupit t'i lënë mënjanë interesat personale për të kërkuar të mirën kolektive. Kjo do të thotë që ata promovojnë bashkëpunim brenda organizatës që lë për të kuptuar se puna e ekipore është e rëndësishme në arritjen e rezultateve më të mira për organizatën. Udhëheqësi transformues është të transformojë veten, të tjerët dhe organizatën (biznesin), pra ai është një udhëheqës ndryshimi ku edhe në ambiente të paqëndrueshme ndjehet i rehatshëm dhe i përqëndruar në transformimin e proceseve dhe njerëzve për një të mirë të përgjithshme.

¹⁰ Helena Kovač, Martina Širol, Marinela Šumanjski "LEADERSHIP HANDBOOK" Sarajevo 2017, fq.26

Udhëheqësi transformues inkurajon sjellje më efektive, punëtorët e tij janë më të motivuar të japin edhe më shumë nga sa pritet prej tyre. Ndjekësit formojnë një lidhje të fortë emocionale me udhëheqësin transformues, duke formuar kështu një vision të përbashkët.

Udhëheqja transformuese sikur edhe udhëheqjet tjera i ka anët e veta pozitive dhe negative.

Si përparësi mund të cekim se lidhshipi transformues ka një ndikim pozitiv në reagimet psikologjike dhe emocionale të ndjekësve, për këtë arsye performanca e tyre në punë është më e lartë, pastaj udhëheqësit transformues janë në gjendje të përshtaten me atë që organizata kërkon prej tyre duke ndikuar në efikasitetin dhe efektivitetin e tyre, me një fjalë këto lloj drejtuesish promovojnë bashkëpunim me çka janë në gjendje t'i përgjigjen në mënyrë efektive kompleksitetit të organizatave.

Ndërsa si disavantazhe duhet të cekim se stili transformues ka pak orientim në detaje, thënë më qartë, sado që udhëheqësit transformues njihen me aftësinë për t'i motivuar ndjekësit, ata kanë pak orientim në detaje, pastaj nuk është një stil për të gjithë ndjekësit, pasi puntorët që janë më të varur nuk janë në gjendje të bëjnë atë që pret udhëheqësi.

Sistemet e udhëheqjes

Sistemet e udhëheqjes janë të llojllojshme. Në pikëpamje të qarkullimit të urdhërave, informatave dhe të propozimeve, si dhe në pikëpamje të ndërlidhjeve ndërmjet vendeve të ndryshme udhëheqëse dhe ekzekutuese, ekzistojnë kryesisht tri sisteme udhëheqëse:

- Sistemi i linjës
- Sistemi funksional dhe
- Sistemi i përzier i udhëheqjes

Sistemi linjor i udhëheqjes- Ky sistem është shumë i vjetër. Sistemi linjor i udhëheqjes bazohet vetëm në udhëheqjen e një personi. Detyra e dhënë nga udhëheqësi deri te punonjësi zbret vetëm nëpër një linjë. Për këtë shkak ky sistem i udhëheqjes emërtohet me këtë emër¹¹. Sipas këtij sistemi në krye të çdo njësie organizative duhet të gjendet nga një udhëheqës, i cili jep këshilla, udhëzime e urdhëra, pra raportet linjore të autoriteteit krijohen me shtimin (zhvillimin) vertikal (hierarkik) të organizatës.¹² Sistemi linjor i udhëheqjes qarkullon sipas linjës, nga niveli më i lartë organizativ e gjer te nivelet më të ulëta, gjë që kuptojmë se secili punonjës i përgjigjet vetëm një udhëheqësi, më konkretisht, shefi i përgjigjet drejtorit, brigadieri i përgjigjet shefit, punëtori i përgjigjet brigadierit, e kështu me radhë.

Sistemi i udhëheqjes sipas linjës i ka përparësitë, por edhe te metat. Si përparësi duhet të përmendim thjeshtësinë dhe qartësinë e shprehur, pasi çdo lëshim që mund të bëhet, vërehet shumë shpejt, ndaj edhe mund të reagoher me kohë. Ndërsa si të meta duhet të cekim se ky sistem shprehet nëpërmjet kërkesave të paqëndrueshme, siç është nevoja për njohuri më të gjera që janë vështirë të arritshme, mospërfillja e duhur për specializime të udhëheqësve dhe mbylljes në vete, vetëm në detyra të caktuara pa u zgjeruar në shërbimin e funksioneve tjera.

¹¹ .Dr.Ali Jakupi “Ekonomia dhe Organizimi i Ndërmarrjes” Prishtinë 1997, fq.82

¹² Prof.Dr.Berim Ramosaj “ Bazat e Menaxhimit” Prishtinë 2000, fq.115

Sistemi funksional i udhëheqjes

Sistemi funksional i udhëheqjes daton që nga periudha e Frederik E. Tejlorit. Është e drejta që i delegohet një individ ose departamenti për të kontrolluar proceset, praktikat e ndërmarra nga personat në departamente të tjera, ose thënë më thjesht urdhëresa për punë e udhëheqësve më të lartë zërthehet në më shumë urdhëresa dhe si të tilla pranohen nga udhëheqësit në nivele më të ulëta. Në këtë mënyrë punonjësi merr urdhëra prej numrit më të madh, prej disa udhëheqësve.¹³ Sipas këtij sistemi çdo punëtor merr udhëzime ose urdhëra për punë apo operacione të ndryshme nga njësitë më të larta organizative.

Sistemi funksional i udhëheqjes ka përparësitë dhe të metat e tij. Përparësitë janë përgatitja e rrugës për zbatimin e parimeve themelore praktike të racionalizimit, ndarja e punëve në funksione (planifikim, përgatitje, ekzekutim, rregullim dhe kontroll etj.) pra punët janë të lidhura me specializime të ngushta në udhëheqje, me çka mund të shprehet aftësi dhe efikasitet më i madh. Ndërsa të metat e sistemit funksional të udhëheqjes janë: ndërlikimet dhe ngatërresat e kompetencave të urdhërdhënësve, moskuptimet e ekzekutuesve, konkurrenca joparimore ndërmjet udhëheqësve etj.

Sistemi i përzier i udhëheqjes

Quhet sistem i përzier i udhëheqjes ngase është produkt i kombinimit të sistemit linjor dhe funksional. Në organizata kryesisht aplikohen sistemet e përziera të udhëheqjes. Zbatimi i këtij sistemi bëhet në tri forma kryesore; e para aplikimi paralel i të dy sistemeve, e dyta aplikimi i përbashkët i sistemit funksional dhe linjor dhe e treta aplikimi i sistemit të këshillave.

Sipas formës së parë, siç e shprehëm më lartë është organizimi paralel i sistemit të linjes dhe atij funksional të udhëheqjes d.m.th. në njërin sektor përdoret ai i linjës, ndërkohë që në sektorin tjetër sistemi tjetër, pra ai funksional, varësisht nga ecuria e punëve dhe e organizimit.

Sipas formës së dytë pra sistemi i përbashkët funksional dhe i linjës gjen vend pothuajse në të gjitha mjediset e udhëheqjes. Në këtë sistem vendimet mbështeten në sistemin linjor, me kusht që udhëheqësit të konsultohen meoemos me specialistët e sektorëve të tjerë dhe kështu kombinohen me elementet e sistemit funksional të udhëheqjes.

Ndërkaq sipas formës së tretë sistemi i këshillave përmban shqyrtimin e vendimeve dhe të këshillave për probleme të caktuara në ndërmarrje, elemente të cilat duhet të zbatohen në mënyrë të mirëfilltë nga të gjithë udhëheqësit. Pra këto vende nuk kanë të drejtë të urdhërojnë, por kanë për detyrë që të ndihmojnë udhëheqjen, dhënien e këshillave për çështjet e ndryshme, ose hartojnë elaborate për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga procesi i drejtimit dhe i udhëheqjes me ndërmarrjen.

Edhe sistemi i përzier i udhëheqjes ka përparësitë dhe të metat e tij. Si përparësi merret pozita e përforcuar e udhëheqësit, pasi që vendimet e tij të udhëheqjes nuk bazohen vetëm në konceptin e mendimeve të tija, por kanë mbështetje nga një numër i nevojshëm specialistësh dhe punonjës profesionistë, me çka shkarkohen nga shumë

¹³ Dr. Ali Jakupi "Vepër e cituar" Prishtinë 1997, faqe 82

obligime me përgjegjësi të cilat në kushte të tjera do t'i kryente vetë. Si përparësi tjetër është se vendimet merren nga një numër i njerëzve që natyrisht janë të trajtuara mirë dhe që janë të zbatueshme.

Ndërsa të metat e sistemit të përzier të udhëheqjes janë se shpeshherë komplikohen punët, ngase kryerësi i punëve merr urdhëra prej dy e më shumë udhëheqësve, pastaj përgjegjësia zvogëlohet pasi që krijohet mundësi të arsyetohen (justifikohen) të metat dhe lëshimet t'i hudhen tjetërkujt.

Konkluzione

Duke e trajtuar këtë temë vijmë në përfundim se udhëheqja si funksion del nga pozita në procesin e punës, ku numri më i madh i të punësuarëve kryen punët ekzekutive, ndërsa numri më i vogël e tyre kryen punët e planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit- pra punët udhëheqëse. Pra udhëheqja është mënyra se si menaxheri e bën ekipin e tij të arrijë secilin komponent përkatës duke iu afruar qëllimeve përfundimtare. Udhëheqësit ofrojnë drejtim dhe vizion, motivojnë dhe frymëzojnë të tjerët për të arritur qëllimet e organizatës dhe ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të favorshëm për sukses duke promovuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis anëtarëve të ekipit.

Udhëheqësit ofrojnë një udhërrëfyes që përshkruan hapat dhe burimet që organizata e tyre ka nevojë për të arritur në destinacionin e preferuar. Ata frymëzojnë të tjerët që të përmbushin objektivat e organizatës dhe ofrojnë një arsye të fuqishme që të gjithë të jenë të përkushtuar ndaj detyrave të tyre.

Udhëheqja efektive balancon interesat personale me objektivat organizative, ata krijojnë një mjedis ku organizata mund të arrijë qëllimet pa sakrifikuar kënaqësinë e punonjësve.

Bibliografia

1. Prof. Dr. Berim Ramosaj” *Bazat e Menaxhimit*”, Prishtinë, 2000.
2. Бобек Шуклев “ *Менаџмент*” Скопје, 1998.
3. Dov Seidman” *How Why How We Do Anything Means Everything... in Business (and in Life)* Published by John Wiley & Sons, Inc Hoboken, New Jersey.2007.
4. Gadaf Rexhepi “ *Menaxhmenti Strategjik*” Shkup, 2016.
5. Prof.ass, dr. Mimoza Kasimati, Prof.ass dr. Mimoza Manxhari “ *Sjellje Organizative*” Tiranë, 2005..
6. Grup autorësh” *Organizimi i Punës*” Prishtinë, 1984.
7. Edward Russel-Walling “ *Menaxhimi*” Tiranë, 2016.
8. Ymer Havolli ”*Menaxhmenti i Burimeve Njerëzore*” Prishtinë, 2014.
9. Dr. Ali Jakupi “ *Ekonomia dhe Organizimi i Ndermarrjes*” Prishtinë, 1997
10. Prof. Dr. Ibrahim Kuka “ *Vendosja Afariste*”, Prishtinë, 1997.
11. Dr. Zhivko K. Kostiq “ *Bazat e Organizimit të Organizatave të Punës së Bashkuar*” Prishtinë, 1984.
12. Charles W. L.Hill ”*Global Business Today*“ Second Edition, New York, 2002.
13. Berim Ramosaj” *Leadership*” Pejë, 2017
14. Taki Fiti, Veland Ramadani “ *Ndërmarrësia*” Tetovë, 2013.
15. David Handerson” *Klasikë të mendimit ekonomik*” Tiranë, 2007.
16. F. Patrick Butler” *Business research Sources-A referenc navigator*” Boston, 1999.
17. Barritt Chuck, Alderman Jr F. Lee, *Creating a Reusable Learning Objects Strategy*, first edition, Pfeiffer, San Francisko, 2004.
18. Belul Beqaj” *Lidershipi*” Prishtinë, 2010.
19. Peter F. Drucker, “*Praksa rukovođenja*” Privreda, Zagreb, 1961.
20. Departamenti i Tregtisë se SHBA-se “ *Etika e Biznesit*” Ribotuar nga Zyra e SHBA-së, Prishtinë. 2007.
21. Batrol, K. Martin, D. “*Menagement*” McGraw-Hill, New, York, 1991
22. Knežević M, Novak M, Sikavica P. *Problemi funkcioniranja i razvoja samoupravnih organizacija*, Zagreb, 1985.
23. Isa Mustafa, “*Lidership-udhëheqja*” *efiçienca dhe efektiviteti*, Prishtinë, Riinvest, 2004.
24. Kukoleča, dr. S., *Ekonomika produzeča*, I i II knjiga, Zagreb, 1960.
25. Mustafa, mr I. “*Bazat e ekonomisë se ndërmarrjes*” Prishtine, 1972.

ROLI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË SISTEMIN BANKAR

MSc. Inxh. Hasan MLINAKU

Student i Doktoratës në Informatikën e Biznesit
Universiteti VUZF, Sofje – Bullgaria
E-mail: hasanmlinaku@gmail.com

&

Bashkëautor: Prof. Ass. Dr. Besnik HAJDARI

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
Universiteti “Isa Boletini” Mitrovicë, Kosovë
E-mail: besnik.hajdari@umib.net

ABSTRACT

The role of Information Technology is a central position for the institution whose activity is generally oriented around information. Information Technology is rapidly becoming a means of communication and integration between the internal functions of the institution, while internal resources are being adapted to enable the growth of the technological infrastructure.

Banking is an issue, a practice, a business, or even a profession as old as human existence itself. It has started to exist from the most primitive forms to the most advanced forms that we encounter today, electronic banking.

During this paper I have analyzed that: The provision of banking services without mediation or direct contact with the bank employee, allowing the client to access services through information technology, requires first a new model of the work process and sophisticated IT systems which, while they use the opportunities offered by the rapid development of technology, they can face many challenges that arise as a result of its use.

ABSTRAKT

Roli i Teknologjisë së Informacionit është një pozicion qendror për institucionin, aktiviteti i të cilit është përgjithësisht i orientuar rreth informacionit. Teknologjia e Informacionit po shndërrohet në mënyrë të shpejtë në një mjet komunikimi dhe integrimi midis funksioneve të brendshme të institucionit, ndërkohë që burimet e brendshme po adaptohen për të mundësuar rritje të infrastrukturës teknologjike.

Bankingu është një çështje, një praktikë, një biznes apo edhe një profesion po aq i vjetër sa dhe vetë ekzistenca e vetë njeriut. Ai ka filluar të ekzistojë që nga format më primitive dhe deri tek format më të avancuara që hasim në ditët e sotme, bankingun elektronik.

Gjatë këtij punimi kam analizur që: Ofrimi i shërbimeve bankare pa ndërmjetësinë apo kontaktin e drejtpërdrejtë me punonjësin e bankës duke i lejuar klientit çasjen e shërbimeve nëpërmjet teknologjisë së informacionit kërkon së pari një model të ri të procesit të punës dhe sisteme informatike të sofistikuara të cilat, ndërsa shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga zhvillimi i vullshëm i teknologjisë janë në gjendje të përballen me sfida të shumta që lindin si pasojë e përdorimit të saj.

ABSTRACT

The role of Information Technology is a central position for the institution whose activity is generally oriented around information. Information Technology is rapidly becoming a means of communication and integration between the internal functions of the institution, while internal resources are being adapted to enable the growth of the technological infrastructure.

Banking is an issue, a practice, a business, or even a profession as old as human existence itself. It has started to exist from the most primitive forms to the most advanced forms that we encounter today, electronic banking.

During this paper I have analyzed that: The provision of banking services without mediation or direct contact with the bank employee, allowing the client to access services through information technology, requires first a new model of the work process and sophisticated IT systems which, while they use the opportunities offered by the rapid development of technology, they can face many challenges that arise as a result of its use.

APLIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË SISTEMIN BANKAR

Sot, kontratat elektronike kanë marrë një zhvillim të madh dhe një rëndësi të konsiderueshme në zhvillimin e marrëdhënieve juridike dhe sidomos në tregtinë elektronike. Në shumë vende të botës po shtohet gjithmonë e më shumë blerjet on-line, kontratat elektronike, komunikimet me mjete elektronike, të cilat po i japin një zhvillim të ri tregtisë në nivel ndërkombëtar. Ato janë bërë një katalizator i fuqishëm për zhvillimin e marrëveshjeve ekonomike pasi realizojnë negocimin për marrëveshje juridike në një kohë të shkurtër dhe janë efikase. Por, kontrata elektronike edhe pse në shumë elementë është e njëjtë me kontratën off-line ajo gjithsesi paraqet disa specifika që duhen trajtuar. E rëndësishme është të trajtohen karakteristikat e saj, avantazhet që paraqet sot për zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike por edhe problematikat. Këto do të trajtohen bazuar në rregullimin e legjislationit tone, por duke u fokusuar kryesisht në praktikat e vendeve të huaja duke marrë parasysh zhvillimin e madh që ka marrë kjo kontratë në gjithë botën.

Shitja është kontrata më e rëndësishme mes kontratave të tjera, me anë të të cilave realizohet qarkullimi i pasurisë në kuptimin më të gjerë të kësaj shprehje. Në Kodin Civil: "kontrata e shitjes ka për subjekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një cmimi". Kontratat e lidhura përmes mjeteve elektronike quhen kontrata në formë elektronike. 2. Propozimi dhe pranimi i ofertës mund të bëhen nëpërmjet mjeteve elektronike, që është forma elektronike e tyre. Në çdo rast, që kontrata elektronike të jetë e vlefshme, duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e parashikuara nga Kodi Civil, për pjesën e përgjithshme të kontratave, kërkesat e parashikuara për formën konkrete të kontratës të parashikuara në ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve"

. Pozita e veçantë që zë kompjuteri së bashku me zhvillimet e mëdha teknologjike kanë ndikuar dhe do të vazhdojnë të kenë ndikim të jashtëzakonshëm pozitiv dhe veçanërisht në zhvillimin e kontratës së shitjes në mënyrë elektronike. Varësisht nga kategoria e produktit, roli i blerjeve elektronike ndryshon. Pothuajse të gjitha hulumtimet mbi përdorimin e internetit tregojnë se produktet kompjuterike, librat, revistat, muzika dhe, në një masë në rritje, shërbimet si udhëtimi janë ndër artikujt më të njohura që do të blihen në Ëeb. Interesi për sende ushqimore, elektronikë, mobilje, fotografi dhe objekte të tjera të artit është shumë më e vogël.

Kontratat

1. Kontratat e lidhura ndërmjet lëshuesve ose agjentëve të tyre, me tregtarët dhe zotëruesit duhet të jenë në formë të shkruar dhe si rezultat i aplikimit paraprak. Ato duhet të përmbajnë detajet për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të marrëveshjes.
2. Kontratat duhet të përpilohen në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
3. Çdo lloj i tarifimit duhet të përcaktohet në mënyrë transparente, duke marrë parasysh kostot dhe rrezikun, por pa e kufizuar konkurrencën.
4. Të gjitha kushtet, nëse janë në përputhje me ligjet në fuqi duhet të negociohen dhe të shprehen qarte në kontratë.
5. Kushtet e veçanta për ndërprerjen e kontratës duhet të përfshihen në kontratë, kurse palët duhet të njoftohen para se të lidhet një kontratë e tillë.



Figure 1: Kontrata elektronike vs Kontrata tradicionale.

Jo të gjitha kontratat që përfundon një bankë kanë të bëjnë me veprimtarinë bankare. Këto kontrata mund të ndahen në: kontrata themelore bankare dhe në kontrata ndihmëse bankare, *për shembull overdrafte*. Por ka edhe kontrata, të cilat pavarësisht se nuk janë të lidhura me klientin quhen kontrata bankare, si të tilla janë kontratat që përfundohen midis vetë bankave.

Këto kontrata quhen kontrata interbankare, p.sh, *kontratat që përfundohen midis bankave për të bashkë financuar një ose disa klientë. Kjo kontratë ka efekte të dyanshme për bankën, nga njëra anë, nëpërmjet kontratës banka siguron burimet e veprimtarisë së saj dhe nga ana tjetër po nëpërmjet kontratës përdor këto burime për të kryer shërbimet bankare.*

Kontrata bankare është veprim juridik i dyanshëm i përbërë nga dispozita detyruese, të cilat burojnë nga marrëveshja midis palëve, e cila në rast se i gëzon të gjitha elementët e vlefshme të kontrates duhet të respektohet njësoj si ligji nga gjykata. Pavarësisht nga objekti i kontratës, palët janë të lira për të negociuar

ndërmjet njëra-tjetrës dhe të arrijnë pëlqimin kontraktor, megjithatë në shumicën e rasteve, pëlqimi kontraktor është thjesht formal, pasi banka ofron produktin bankarvetëm me kusht që klienti të pranojë kushtet e vetë bankës.

Bankat hartojnë dhe përdorin formastandarde të kontratave, në mënyrë që të ushtrojnë veprimtarinë bankare sipas kushteve që ato dëshirojnë.

Nevoja për përdorimin e kontratës së shitjes në formë elektronike

Shoqëria jonë moderne mbështetet në një sistem ekonomik që bazohet kryesisht në mekanizmin e kontratave. Tani për tani shoqëria jonë industriale dhe e shërbimit po ndryshon më shumë drejt shoqërisë moderne të informacionit. Një nga treguesit më të rëndësishëm që tregon këtë ndryshim është rritja e ekonomisë dixhitale. Në këtë këndvështrim, mund të themi se, në ditët e sotme, interneti dhe zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë së informacionit, kanë rezultuar në ndryshimin e standarteve të jetesës. Vitet e fundit, është bërë një progres i ndjeshëm në kuadër të tregtisë elektronike, përsa i përta përket lehtësimit të biznesit përmes kryerjes së shërbimeve në mënyrë elektronike. Si rezultat i zhvillimit të teknologjisë dhe tregtisë elektronike, lindi nevoja për përdorimin e kontratës së shitjes në formë elektronike, si një mënyrë më e shpejtë për të kryer biznes. Kur marrëdhëniet e caktuara shoqërore pretendohen të rregullohen me kontratë, duhet të konstatojmë se si parim i shprehjes së vullnetit të lirë të palëve në të drejtën e detyrimeve konsiderohen: - Liria e palëve kontraktuese që të lidhin apo të mos lidhin kontratën dhe se ato i detyron vetëm vullneti i tyre; - Liria e subjekteve të së drejtës që të zgjedhin personin me të cilin do të lidhin kontratë; - Liria e subjekteve të së drejtës që sipas dëshirës së tyre të përcaktojnë përmbajtjen, kushtet dhe formën e kontratës; - Liria e plotë e kontraktuesve që pasi të kenë lidhur kontratë me vullnetin e tyre ta ndryshojnë ose ta shuajnë tërësisht kontratën e lidhur. Mirëpo, në teorinë juridike është i pranuar fakti se kontrata e lidhur në mënyrë legale, duhet të jetë ligj për palët, dhe se marrëveshja që e kanë arritur palët duhet të respektohet. - “pacta sunt servanda”. Nëse i analizojmë dhe i përcjellim me vëmendje kontratat, duke e pasur parasysh veprimin e tyre juridik, ato mund t'i ndajmë në tri grupe:

- a) Kontratat me të cilat krijohen detyrimet;
- b) Kontratat me të cilat ndryshojnë marrëdhëniet detyrimore dhe
- c) Kontrata me të cilat shuhen marrëdhëniet detyrimore.

Kontratat Elektronike

Ja disa informata të rëndësishme në lidhje me kontratat elektronike dhe me atë se çfarë me të vërtet duhet të dimë për to. Kontratat elektronike në parim janë të njëjta me kontratat e rregullta. Në fakt ne nuk i nënshkruajmë ato, por përderisa ne shtypim emrin tonë, do të thotë se kemi për synim të nënshkruajmë dokumentin, e që është e njëjta gjë sikur të nënshkruajmë. Ato kanë domethënie të njëjtë si kontratat e rregullta dhe detaizojnë specifikat e biznesit apo sprovave në mes të dy kompanive apo njerëzve. Përmes kontratës elektronike ne jemi në gjendje të detaizojmë specifikat e çmimeve, produkteve, datave si dhe informatave tjera, në të njëjtën mënyrë sikurse tek kontratat e zakonshme.

Kontratave elektronike janë po aq legale sa janë edhe kontratat e rregullta, dhe vetëm për shkak se nuk i nënshkruajmë ato, nuk do të thotë se nuk janë reale dhe se nuk kemi nevojë ti përmbahemi termeve në kontratë. Normalisht, format e kontratave mund të gjinden edhe në internet, dhe ato mund ti përdorim duke i shtuar informatat e rëndësishme të kompanisë.

Aty kemi mundësi ti ndryshojmë gjërat deri sa kontrata nuk bëhet sipas dëshirës sonë. Të gjitha kontratat elektronike duhet të shtypen apo printohen të paktën nga një herë, pastaj duhet të ruajmë një kopje të kontratës elektronike në kompjuterin tonë, në një fajll të specifikuar për të gjitha kontratat. Të drejtat të cilat janë përfshirë në kontratën elektronike kanë domethënien e njëjtë sikurse kontratat tipike. Shumë njerëz mendojnë se nëse bëjnë biznese online apo përmes internetit si të pavarur, ata nuk kanë nevojë për kontrata. Kjo thjesht nuk është e vërtetë. Kontratave janë shumë të rëndësishme në çdo biznes, dhe ne duhet ti përfshijmë në çdo punë që bëjmë. Në këtë mënyrë ne mund të mbrojmë vetën dhe klientët nga mosmarrëveshjet që mund të shfaqen më vonë. Siç thamë format e kontratave elektronike mund të gjendem edhe në internet, dhe në ato forma ne mund ti bëjmë ndryshimet në atë mënyrë që të reflektojnë kushtet e biznesit tonë. Aty kemi mundësi që shumë lehtë t'i ndërrojmë kushtet, klauzatat dhe formulojmë varësisht se cili klient do të marr kontratën për ta nënshkruar. Nëse klienti na e dërgon një kontratë elektronike për ta nënshkruar, duhet ta lexojmë me shumë kujdes çdo reshtë të tekstit para se ta nënshkruajmë atë. Sikurse tek kontratat e rregullta, është me rëndësi të dimë se çfarë po nënshkruajmë.

Nënshkrimet elektronike dhe ato digjitale

Nënshkrimi - është një shkrim i stilizuar i lidhur me personin. Është i krahasueshëm me një vulë apo ngjitëse vule. Në tregti dhe në drejtësi, nënshkrimi në dokument është indikacion që personi pajtohet me qëllimet e paraqitura në dokument.

Nënshkrimi Elektronik

Nënshkrim elektronik është çdo mjet elektronik i pranuar me ligj që tregon se personi miraton përmbajtjen e mesazhit elektronik. Nënshkrimi elektronik përfshin të gjitha llojet e nënshkrimeve elektronike si: emri i shtypur, e-mail adresa, nënshkrimi digjital apo nënshkrimi i skanuar. Termi nënshkrim elektronik ka disa kuptime. Sipas ligjit të SHBA-ve nënshkrimi elektronik nënkupton “një tingull elektronik, simbol ose proces, i ngjitur ose i bashkangjitur në mënyrë logjike me një shënim dhe i ekzekutuar ose i adaptuar nga një person me qëllim të nënshkrimit të shënit.” Ky definicion vjen nga Akti Uniform i Transaksioneve Elektronike ose UETA (ang. Uniform Electronic Transactions Act) dhe për herë të parë u përdor në vitin 1999.

Vet koncepti nuk është edhe aq i ri. Shumë ligje në Evropë dhe botë përmbajnë referenca për nënshkrime telegrafike ose nënshkrime të faksuar, disa bile edhe në mesin e shekullit të 19-të. Për më shumë, në SHBA ka propozime që shënimet dhe nënshkrimet elektronike të jenë të pranueshme edhe në gjykatë.


Në drejtësi, nëse kontestohet nënshkrimi në kontratë ose ndonjë dokument tjetër, nënshkrimi duhet të përmbush disa teste të caktuara para se gjykata të bazohet në to. Këto kërkesa dallojnë varësisht nga juridiksioni, por llojet e ndryshme të nënshkrimeve, disa edhe plotësisht elektronike, telegrame, dhe faksimile të dokumenteve, bile edhe në disa raste të pa nënshkruara nga dërguesi.

Pyetje qendrore në këto raste është falsifikimi dhe aprovimi i rremë, dhe në këto vendime, gjykatat kanë vendosur se falsifikimi dhe aprovimi i rremë mund të përjashtohen nga praktika. Për më shumë, është shumë lehtë e mundshme, për shumë mënyra elektronike të nënshkrimit, ose për nënshkrimet e ngjitura, të falsifikojnë ose mashtrojnë aprovimin. Problemi gjithnjë e në rritje i vjedhjes së identitetit ilustron shumë nga këto falsifikime. Shpesh, bizneset mbështeten në mjetet tjera për të provuar të sigurojnë se një nënshkrim elektronik është i rregullt, duke përfshirë edhe bisedën e drejtpërdrejtë me personin para se të bëhet nënshkrimi elektronik, sidomos në rastet e vazhdimësisë së biznesit, dhe të pranimit të pagesave ose të indikacioneve tjera të qëllimit të bërjes së biznesit që nuk varen vetëm nga një dokument i nënshkruar.

Nënshkrimet digjitale

Nënshkrimi Digjital është një vlerë numerike dhe unike e bazuar në gjithë dokumentin e shtypur që është nënshkruar. Për shkak të ligjeve të BE dhe Britanisë së madhe, vetëm nënshkrimet digjitale janë të pranueshme si fakte në gjykata. Nënshkrimet digjitale marrin konceptin e nënshkrimit tradicional në letër dhe e shndërrojnë atë në “gjurmë elektronike të gishtërinjve”. Nënshkrimet digjitale mundësojnë migrimin e lehtë prejproceseve të pavolitshme të bazuara në letër drejt një ambienti të sigurt dhe efikas pa letër. **Figure 2:** Nënshkrimi Elektronik “Gjurmët e gishtërinjve” ose mesazhi i koduar është unik për nënshkruesin dhe për dokumentin. Kjo siguron se personi i cili ka nënshkruar, është në vërtetë origjinatori i porosisë. Gjurmët e gishtërinjve nuk mund të ri-përdoren ose ti rikaktohen ndokujt tjetër në cilëndo kohë tjetër. Nënshkrimi digjital autentikon origjinatorin e porosisë dhe përcakton se porosia nuk ishte e ndryshuar pas dërgimit. Nëse çfarëdo ndryshimi ishte bërë pasi të është nënshkruar dokumenti, ai në mënyrë automatike ka bërë jo të vlefshëm dokumentin dhe në këtë mënyrë do ta mbroj atë nga falsifikimi. Një dallim i qartë qëndron në mes të nënshkrimeve elektronike dhe atyre digjitale, edhe pse këto dy terme shpesh përdoren në shkëmbim të njëri tjetrit: Nënshkrimet digjitale (nganjëherë të referuara edhe si nënshkrime elektronike të avancuara ose të sigurta) janë rezultat i një veprimi kriptografie. Teknologjia që qëndron prapa nënshkrimeve digjitale është një standard i industrisë që njihet si Infrastruktura e Çelësit Publik ose PKI (ang. Public Key Infrastructure), e cila garanton integritetin e shënimeve dhe mospranimin e transaksioneve. Nënshkrimidigjital nuk mund të kopjohet,

ngatërrohet ose ndryshohet. Në anën tjetër, nënshkrimet elektronike janë imazhe elektronike që në mënyrë fizike ose logjike i ngjiten të dhënave të nënshkruara. Duke shtuar fjalën “Unë, Arlinda Kadrija nënshkruaj këtë dokument” mjafton që të konsiderohet si nënshkrim elektronik, është e qartë pra se nënshkrimet elektronike janë të lehta për tu falsifikuar, për ndryshim nga nënshkrimet digjitale.



Përmes nënshkrimeve digjitale në mënyrë të lehtë mund të nënshkruajmë në mënyrë digjitale dokumentet, fajllat format dhe transaksionet derisa në të njëjtën kohë jemi të mbrojtur nga falsifikimi i nënshkrimit. Përmes implementimeve të ndryshme të nënshkrimeve digjitale organizatat e ndryshme mund të vendosin nënshkrime në një numër të aplikacioneve siç janë Microsoft Word, Adobe Acrobat etj. Nënshkrimet digjitale “vulosin” dokumentet elektronike, duke siguruar autenticitetin, integritetin dhe besueshmërinë e transaksioneve elektronike.

Rekomandimet

- Bankat në vend duhet të rrisin dhe të përmirësojnë anagazhimin e tyre në promovimin e programit financiar elektronik
- Ato duhet të ndikojnë në perceptimet e klientëve ndaj programit dhe në bashkeveprimin e stafit për të mundësuar këtë ndikim
- Bankat duhet të sigurojnë që përdorimi i programit të jetë i thjeshtë dhe i sigurtë gjatë realizimit të transaksioneve të ndryshme. Në këtë mënyrë, klientët mund të kenë një nivel më të lartë besimi, duke ndryshuar qëndrimin mbi përdorimin e programeve përkatëse.
- Banka mund të nxisë njohuritë ndaj produkteve që ofron duke organizuar sëminarie të ndryshëm, konferenca, etj. Duke qënë së përdorimi i internetit dhe i telefonit është gjithmone e me shume në rritje të vazhdueshme, ngjarje të tilla mund të ndihmojnë duke dhënë informacionë më shumë individëve dhe duke nxitur qëllimin për të përdorur shërbimet bankare në telefon në të ardhmen e afërt.

- Bankingu elektronik mund të ndihmojë që banka të arrijë të operojë në tregje më të gjera. Ky këndvështrim është i rëndësishëm për Kosovën, për arsye të rrjetit bankar është i përqëndruar më së shumti në qytetet kryesore. Në përdorimin e m-banking mund të synohet arritja e klientëve edhe në zona të tjera gjeografike në të cilat hapja e një degë banke paraqitet me kosto shumë të larta.

Konkluzionet

- Bankingu elektronik paraqet një tërësi përfitimesh edhe për përdoruesit e tij. Ata mund të kenë akses në llogarinë e tyre bankare në çdo kohë dhe në çdo vend, mjafton të ketë telefonin e përshtatshëm dhe casjen në internet.
- Sa do të zhvillohet dhe do të përhapet ky lloj i ri i bankikut? Sa do të arrijë të pranohet gjerësisht nga njerëzit në të gjithë botën? Kjo varet nga shumë faktorë, ndër të cilët do të veçoja me siguri e bindje të plotë: traditën, e cila i ka mësuar njerëzit t'ia besojnë “sekretet e tyre financiare” dikujt që ushtron profesionin e bankierit.
- E rëndësishme është që tregu bankar duhet të funksionojë në mënyrën më efikente të mundshme, në mënyrë që mirëqenia sociale dhe financiare e varur prej saj të jetë maksimale.
- Politikat rregulluese duhet të zgjedhin strukturën më efikente, pavarësisht se kjo do të kërkonte më tepër konkurrencë, për aq kohë sa këto politika kanë mundësi të nxitin bankat të sillen me kujdes në çfarëdo lloji strukture.

Përfundimi

Ndryshimi i kushteve jetesore dhe dinamizmi i jetes nxiti nevojat për shërbime bankare elektronike, të shpejta dhe të thjeshta. Zhvillimet në fushën bankare dhe në atë teknologjike kanë ndikuar në mundësinë e përdorimit të telefonave si një mjet për të aksesuar llogarinë bankare, pa patur nevojë për të qënë fizikisht i pranishëm në një degë banke. Një teknologji e tillë po gjen zbatim të gjerë edhe në Kosovë, duke mundësuar casjen e llogarisë bankare nga klientet në çdo kohë dhe nga çdo vend. Në një botë e cila është e orientuar nga zhvillimi i teknologjisë së informacionit, koha është një element i rëndësishëm për cilindo. Pra, nëpërmjet mobile banking, klientët mund të kontrollojnë në mënyrë të detajuar llogarinë e tyre, duke marrë vendimet e duhura financiare në një kohë më të shkurtër. Duke përfunduar këtë punim diplome inkurajojmë studiuesit e ardhshëm të hulumtojnë dhe të analizojnë me shumë për menaxhimin dhe zhvillimin e bankikut në Republikën e Kosovës. Dhe shpresoj që ky punim ka arritur të kontribuojë në literaturën e studimit të pranimit të shërbimeve bankare në formën elektronike në vendin tonë.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

- Prof.Ass. Dr. Lumnije Thaçi Punim i doktoratures ‘ *Aspekte të menaxhimit të afarizmit bankar – tregu i kredidhënies si një ndër instrumentet e sigurimit të një rritjeje të qëndrueshme ekonomike në Kosovë*’.
- Prof.Ass. Dr. Besnik Hajdari ‘ *Aplikimi i shërbimeve elektronike në Republikën e Kosovës*’ Konferenca e V-të shkencore ndërkombëtare “*Politikat qeveritare dhe zhvillimi ekonomik rajonal i Evropës Juglindore*.”
- Bessis, J. *Risk Management in Banking*, Eiley-2003, 3rd edition.
- Prof.Ass.Dr. Orfea Odhuci, *Advanced Bank Management 2009*
- Prof.Ass.Dr. Nexhmije Vokshi Berisha, *Kontrolli i brendshëm dhe auditimi, Prishtinë 2015*.
- Prof.Ass.Dr. Edmond Beqiri, *Sisteme informacioni te menaxhmentit, Tetove 2010-2011*
- Prof.Ass. Dr Gazmend Luboteni, *Banka dhe afarizmi bankar, Prishtinë, 2006*
- Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) (2016). *Permbledhje e indikatorëve kryesore te komunikimeve elektronike. “Pasqyre e tregut te komunikimeve elektronike”, per TMI 2016.*

EDUCATION IN FUNCTION OF THE LABOR MARKET AND THE ECONOMY: ANALYSIS OF STUDY PROGRAMS OF HIGHER EDUCATION FROM THE PERSPECTIVE OF UHZ

Prof.ass.dr. Driton Sylqa¹

Prof.asoc.Theranda Beqiri²

^{1,2} University “Haxhi Zeka”, Pejë

Abstract

The manuscript is based on the analysis of the competitiveness among the HEIs in Kosovo regarding the study programs in order to harmonize with the industrial needs. According to the national strategy for education, reforms in higher education include the profiling of programs and universities itself. The number of students has been decreasing for several years now for various reasons, which inevitably reflects the impact of higher education study programs. In this spectrum, the similarity of programs offered by HEIs is considered direct competition. On the other hand, the lack of close connection of the existing study programs with the labor market presents a national problem related to the perspective of young people. Consequently, this paper aims to provide an analytical overview of HEI study programs in Kosovo, which are considered as competitors of UHZ. The primary empirical data were obtained from the relevant institutions, as well as from the relevant state and international reports related to the issue in question. Comparative analysis and data processing result in the construction of a matrix which provides an insight into the similarities of the programs. The contribution of this paper lies in providing an overview for the long-term orientation of UHZ, but also of other HEIs in Kosovo in the selection of programs for which there is a lack of supply and the elimination of those for which there is an excess of demand, always assuming their correlation with the current needs of the labor market.

Keywords: higher education, labor market, economic growth, competition, HEI, etc

Hyrje

Në ekonominë moderne, arsimit është parakusht themelor për zhvillim ekonomik dhe përmirësim të standardit jetësor. Arsimit i lartë në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin për Arsimin e Lartë. Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë funksionon përmes universiteteve publike dhe institucioneve private të arsimit të lartë. Konkurrenca e Universitetit “Haxhi Zeka” vjen nga institucionet publike dhe private të arsimit të lartë të akredituara sipas legjislacionit në fuqi. Sipas të dhënave zyrtare të MASHTI-t, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë në vitin akademik 2020/21, përbëhet nga 24 institucione të akredituara, prej të cilave 9 institucione janë publike dhe 15 institucione janë private. Me këtë numër të institucioneve të arsimit të lartë, Kosova vazhdon të mbetet një ndër vendet me numrin më të madh të institucioneve të arsimit të lartë për një milion banorë. Institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë, në vitin akademik 2020/2021, ofrojnë 400 programe të studimit, prej të cilave 236 programe të studimit janë të nivelit bachelor, 156 të nivelit master dhe 8 programe të studimit të nivelit të doktoratës (MASHTI, 2022).

Bazuar në strategjinë e MASHTI për arsimin 2022 – 2026, në vitet e fundit numri i studentëve në arsimin e lartë është në rënie dhe kjo rënie është më e madhe tek institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë.

Në vitin akademik 2020/21, në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë, kanë vijuar studimet 95,335 studentë (57.4% në sektorin publik, 42.6% në sektorin privat), prej të cilëve 58.5% vajza/gra. Bazuar në të dhënat e fundit në vitin 2020/21, rreth 56.3% bruto e studentëve të grup-moshave 18-22 vjeç, ndjekin arsimin e lartë në Kosovë. Pjesëmarrja e femrës në arsimin e lartë është në nivel të kënaqshëm. Vajzat/gratë përbëjnë 59.5% të studentëve në sektorin publik dhe 57.1% të studentëve në sektorin privat. Indeksi i paritetit gjinor në arsimin e lartë në Kosovë është 1.41 (MASHTI, 2022).

Universiteti më i madh publik është Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me 7,652 studentë, ndërsa IAL-të më të mëdha private janë Kolegji AAB (me 10,064 studentë) dhe Kolegji UBT (me 4,127 studentë). Kjo rritje e shpërndarjes në nivelin baçelor erdhi si rezultat i një vendimi akreditimi për të mos regjistruar studentë të rinj në tre universitete publike që nuk plotësonin kriteret e akreditimit në vitin 2019 (EU Erasmus, 2020).

Gjatë vitit 2020/21, kanë diplomuar rreth 10,997 studentë në nivelin baçellor dhe master në programe të ndryshme të studimit në sektorin publik dhe privat, që është 20% më pak të diplomuar sesa në vitin paraprak akademik. Sektori publik kontribuon me rreth 56% të të diplomuarve. Të dhënat tregojnë se vajzat/gratë u përgjigjen më mirë obligimeve të tyre sesa djemtë/ burrat, ku 66.2% e të diplomuarve janë vajza/gra. Megjithatë, shkalla e diplomimit me kohë e studentëve kosovarë, nuk është e kënaqshme. Nga një studim mbi punësueshmërinë e studentëve rezulton se 65% e të diplomuarve të UHZ janë të punësuar në sektorin privat dhe publik, nga të cilët rreth 3% deklarohen si të vet-punësuar (UHZ & Shoqata Alumni, 2013)

Definimi i Problemimit

Zhvillimi adekuat i arsimit në Kosovë për një fuqi punëtore që i përshtatet nevojave të tregut përbën kushtin parësor për zhvillim dhe prosperitet. Marrë parasysh interesin e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, është kyçe që fuqia punëtore të sigurojë përputhshmëri të aftësive me tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës. Megjithatë, ofrimi i programeve të studimit të cilat nuk reflektojnë nevojat reale të tregut të punës mbetet mangësi strukturore e arsimit të lartë në Kosovë. Njëkohësisht, këtyre programeve iu mungon edhe aspekti ndër-disiplinor, pjesa e mësimi praktik si dhe ndërlidhja me kërkimin shkencor. Rreth 60% të programeve studimore që ofrohen janë nga fusha e edukimit, arteve dhe shkencave humane, shkencave shoqërore dhe shërbimeve. Numri më i madh i studentëve dhe programeve arsimore janë në kategorinë e shkencave shoqërore dhe studimit të së drejtës. Orientimi i studentëve në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë mbetet i ulët. Vërehet një dallim i theksuar në orientim në fusha të caktuara të studimit në arsimin e lartë sipas gjinisë. Femrat janë të prira të jenë të orientuara (mbi 90%) në programet e edukimit, shkencave natyrore, shkencave shoqërore, mjekësisë, komunikimit dhe gjuhësisë. Gjersa, meshkujt dominojnë në fusha të studimit të informatikës, humanistikës, gjeografi/gjeologji dhe inxhinieri/teknologji. Një orientim i baraspeshuar gjinor vërehet në fushat e arkitekturës, biznesit dhe drejtësisë. Shkalla e orientimit të studentëve në fushat e studimit në shkencë shoqërore, humane, biznes dhe juridik është shumë e lartë në krahasim me dinamikën e tregut. Ndërlidhje e ulët e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, oferta e kufizuar e programeve ndërdisiplinore të studimit, kërkon ndërlidhje më të mirë të arsimit të lartë me tregun e punës përmes harmonizimit të programeve të studimit.

IAL, të vetëdijshme për situatën e përgjithshme të arsimit të lartë në Kosovë, për vështirësitë që të diplomuarit hasin në punësim, për kërkesat e sektorin privat për profesione specifike, duhet të ndjekin kursin e baraspeshës në mes të ofertës dhe kërkesës në këtë aspekt. Në anën tjetër, shmangia nga programet studimore që ofrohen në masë të konsiderueshme nga institucionet homologe, apo shmangia nga programet për të cilat ka kërkesë të vogël në tregun e punës do duhej të jetë prioritet strategjik i secilit IAL. Programet që ofrohen dhe njohuritë/shkathtësitë që fitohen nga studentët nuk janë çdo herë në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Metodologjia

Punimi është bazuar në të dhënat e mbledhura nga burimet e ndryshme si: raporte zyrtare, të dhëna statistikore dhe hulumtime lidhur me problematikën e harmonizimit të programeve studimore me nevojat e tregut të punës. Metodologjia e studimit bazohet në një qasje mikse, e cila ka bërë të mundur që të përmbushet qëllimi i studimit. Pasi që autorët janë mësimdhënës të karrierës me përvojë të gjatë akademike, në këtë punim është përdorur metoda shkencore e interpretimit të të dhënave apo metoda hermeneutike e përpunimit të të dhënave për të nxjerrë konkluzione konkrete nga ky studim. Analiza e të dhënave është bërë nga perspektiva krahasimore, duke marrë për bazë programet studimore të UHZ për krahasim me programet studimore të IAL-ve të tjera në Kosovë.

Qëllimi i analizës së të dhënave të mbledhura nga burimet e cekuar është rishikimi i programeve aktuale dhe hartimi i programeve të reja që janë në përputhje me kërkesat e komunitetit të gjerë të biznesit. Për shkak të trendin negativ të rënies së interesimit dhe numrit të studentëve konsiderohet se programet e ngjashme studimore që ofrohen nga IAL-të përbëjnë konkurrencë të panevojshme. Rezultatet e këtij punimi bëjnë të mundur poashtu eliminimin e mundshëm të konkurrencës. Rrjedhimisht, hartuesit e programeve të universiteteve dhe kolegjeve në Kosovë do të kenë një pasqyrë të qartë në formë të matricës mbi programet ekzistuese studimore.

Prandaj, analiza studimore e këtij punimi mund të shërbejë si instrument lehtësues për UHZ në radhë të parë, e më pastaj edhe për IAL-të e tjera në Kosovë në përgatitjen e planifikimit strategjik për ofrimin e adekuat të programeve të studimit. IAL-të duhet të marrin në konsideratë ofrimin e programeve profesionale sipas nivelit 5 të KKK. Në këtë mënyrë, përmes llojshmërisë së programeve të ofruara, mund të rritet edhe interesimi i studentëve për t'i ndjekur ato. IAL iu rekomandohet të realizojnë hulumtime të rregullta për programet aktuale që ofrohen, si dhe të ndërmarrin kërkime për nevojat e tregut të punës. Brenda tërësisë së hulumtimit, duhet të trajtohen edhe mundësitë e orientimit të njohurive dhe shkathtësive drejt nevojave të tregut të punës dhe vetëpunësimit.

Korniza teorike dhe interpretimi i të dhënave

Personeli në IAL publike dhe private

Sipas të dhënave në vitin 2020/21, në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë në marrëdhënie të rregullt pune janë 1,369 anëtarë të personelit akademik dhe 722 bashkëpunëtor të jashtëm, ndërsa në institucionet private të arsimit të lartë në marrëdhënie të rregullt pune janë 1,906 anëtarë të personelit akademik dhe 701 bashkëpunëtor të jashtëm. Raporti profesor-student në institucionet publike është 1:42 ku në një situatë më të vështirë është Universiteti i Pejës. Raporti profesor studentë në institucionet publike, përkundër përmirësimit, vazhdon të mbetet i lartë, krahasuar me universitetet në vendet e rajonit. Ky raport përmirësohet deri në një masë kur llogariten edhe stafi akademik i angazhuar me honorar, edhe pse nuk duhet anashkaluar faktin se një pjesë e mirë e tyre mund të jenë personat e njëjtë, që punojnë në disa institucione të arsimit të lartë njëkohësisht. Numri i pamjaftueshëm i personelit akademik të kualifikuar ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit të lartë. Në këtë drejtim, rreziku tjetër që bartë numri i pamjaftueshëm i personelit akademik të kualifikuar janë grupet e mëdha të studentëve, ku mësimdhënësit nuk arrijnë t'u kushtojnë kujdesin e duhur nevojave individuale të studentëve, ndërkohë që procesi i vlerësimit të njohurive mund të kalojë në mënyrë sipërfaqësore.

Shpërndartja e studentëve në IAL-të publike dhe private

Arsimi i lartë në Kosovë ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet ofruesve publikë dhe privatë pas rritjes së madhe të IAL-ve në 15 vitet e fundit. Ofruesit publikë dhe privatë janë të akredituar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA). Ofruesit jopublik / privat kanë të drejta të barabarta sipas Ligjit për Arsimin e Lartë. Sipas nenit 11 të Ligjit për Arsimin e Lartë, ofruesit e IAL-ve mund të krijohen nga kompani private, fondacione dhe truste dhe t'i nënshtrohen procedurave të akreditimit dhe licencimit të përcaktuara në këtë ligj. Dallimi i vetëm qëndron në themelimin, procesin

e miratimit të statutit, financimin dhe organizimin. Përveç kësaj, ofruesit privatë nuk lejohen të ofrojnë kualifikime mësimore.

Tabela 1. Regjistrimet sipas niveleve të KKK në vitin akademik 2019/2020

KKK	IAL Publike në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera	IAL në gjuhën serbe	IAL Private	Gjithsej	% sipas nivelit
Niveli 5	0	582	27	27	0.1
Niveli 6	6969	1195	14606	21575	72.7
Niveli 7	2629	1237	2310	4939	16.6
Niveli 8	82	47	0	82	0.3
Nr. Total	9680	3061	16943	29684	

Burimi: Pasqyrë e përgjithshme e sistemit të edukimit të lartë, BE / Projekti Erasmus (2020)

Për nivelet 5 dhe 6 të KKK, shpërndarja e studentëve është më e lartë në IAL-të private, ndërsa për nivelet 7 dhe 8 shpërndarja është më e lartë në IAL-të publike. Është me rëndësi të theksohet se nuk ka asnjë student të regjistruar për nivelin 5 në IAL-të publike në gjuhën shqipe dhe nuk ka asnjë të regjistruar për nivelin 8 në IAL-të private. Të dhënat për regjistrimin e studentëve sipas KKK 5, 6, 7 dhe 8 në IAL-të publike dhe ato private janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Regjistrimet e studentëve sipas fushës së studimit në IAL-të publike dhe private

Sipas të dhënave të paraqitura në raportin e Erasmus “Pasqyra e përgjithshme e sistemit të edukimit të lartë në Kosovë”, në vitin e parë të studimeve në arsimin e lartë në vitin 2019 janë regjistruar gjithsej 30.269 studentë. Prej tyre, 9.571 në IAL publike respektivisht, 17637 në IAL private, gjersa pjesa tjetër prej 3061 i referohet IAL në gjuhën serbe. Është për t’u theksuar e dhëna se numri i studentëve të regjistruar në IAL private është gati 2 herë më i madh sesa në IAL publike, edhe përkundër pagesës mjaft të lartë që aplikojnë këto institucione private në krahasim me IAL publike.

Sipas të njëjtit burim, numri më i madh i studentëve të regjistruar është në Studimet e Biznesit dhe në Shkencat e Menaxhimit (19,41%), të ndjekur nga Shkencat Mjekësore (17, 82%) dhe Juridike (10,50 %). Nga të gjitha fushat e studimit të listuara në tabelë, shkencat mjekësore në IAL private dominojnë duke regjistruar gati 10 fish më tepër studentë sesa IAL publike në këtë fushë studimi. Në tabelën vijuese janë paraqitur regjistrimet përkatëse të studentëve sipas fushës së studimit dhe kodeve ISCED 2011 (Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Edukimit).

Tabela 2. Regjistrimet e studentëve sipas niveleve të KKK në vitin akademik 2019/2020 në IAL

Kodi	Fusha e studimit sipas Erasmus	IAL publike (gjuhë shqipe dhe të tjera)	IAL publike në gjuhën serbe	IAL private	Total	%
01	Shkencat Bujqësore	404	107	226	737	2.43
02	Arkitekturë, Planifikim Urban dhe Regjional	323	162	1058	1543	5.10
03	Art dhe Dizajn	288	88	784	1160	3.83
04	Studimet e Biznesit dhe Shkencat e Menaxhimit	2116	461	3297	5874	19.41
05	Edukim, Trajnim për edukatorë	1029	274	0	1303	4.30
06	Inxhinjeri, Teknologji	941	377	1674	2992	9.88
07	Gjeografi, Gjeologji	169	261	0	430	1.42
08	Shkenca Humane	333	67	0	400	1.32
09	Shkenca filologjike dhe gjuhësore	547	167	867	1581	5.22
010	Drejtësi / Juridik	1170	203	1806	3179	10.50
011	Matematikë, Informatikë	207	186	865	1258	4.16
012	Shkenca Mjekësore	545	153	4696	5394	17.82
013	Shkenca Natyrore	241	116	0	357	1.18
014	Shkenca Shoqërore	830	185	1691	2706	8.94
015	Shkenca të Komunikimi dhe Informatikës	180	62	258	500	1.65
016	Edukatë fizike, Shkenca të Sportit	248	192	415	855	2.82
Total/ All Subject Areas		9571	3061	17637	30269	100.00

Burimi: Pasqyrë e përgjithshme e sistemit të edukimit të lartë, BE / Projekti Erasmus (2020)

Ngjashmëria e programeve studimore të IAL

Në vijim prezantohet tabela e IAL-ve publike dhe private të akredituara në Kosovë, sipas njësive të tyre akademike. Për shkakun se UHZ ka 5 njësi akademike, në tabelë përfshihen vetëm njësitë akademike / fakultetet e IAL-ve tjera të ngjashme me ato të UHZ, pavarësisht numrit të tyre. Në këtë mënyrë mundësohet krahasimi i të gjitha IAL-ve që ofrojnë studime të organizuara nëpër njësitë e tyre akademike, gjegjësisht nëpër fakultete përkatëse. Disa nga IAL private (kolegjet) nuk janë të organizuara sipas njësive akademike, prandaj jepen shënime sipas fushën së studimit të programeve të tyre. Gjithashtu, në tabelë përfshihen vetëm IAL, të cilat kanë programe të ngjashme me ato të UHZ-së dhe të cilat konsiderohen se mund të kenë ndikim konkurrues me programet e UHZ. Megjithatë, ndikim më të theksuar kanë të gjitha programet e ngjashme që ofrohen në qytetet e regionit të Dukagjinit për shkak të distancës relativisht të afërsisë.

Tabela nr.3 Krahasimi i UHZ me IAL-të sipas njësive akademike

Fakulteti i Biznesit	Fakulteti i MTHM – së	Fakulteti Juridik	Fakulteti i Agrobiznesit	Fakulteti i Arteve – dega e muzikës
1 UNIVERSITETI I PRISHTINËS				
Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	Fakulteti i Bujqësisë	Fakulteti i Artit – Dega e muzikës
2 UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN – 6 FAKULTETE				
Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	X
3 UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË				
Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	Fakulteti Tek.Ushqim	X
4 UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” GJILAN				
Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	X
5 UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ				
Fakulteti i Menaxhmentit	Fakulteti Turizmit dhe Ambientit	X	X	Fakulteti i Arteve të Aplikuara
6 UNIVERSITETI “FEHMI AGANI” GJAKOVË				
X	X	X	X	X
6 KOLEGJI AAB – PRISHTINË				
Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	Fakulteti i Arteve
6.1. Kolegji AAB me Degë në: Gjakovë				
Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	X
6.2 Kolegji AAB me Degë në: Ferizaj				
Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	Fakulteti i Arteve
7 KOLEGJI UBT - KAMPUSI KRYESOR - PRISHTINË				
Fak. Menaxhment, Biznes e Ekonomi	X	Fakulteti Juridik	Fakulteti i Agrokulturës	Fakulteti i Arteve
7.1. Kolegji UBT Kampusi në: Pejë - ofrohen vetëm dy programe konkurrençe sipas AKA				
7.2. Kolegji UBT kampusi në Prizren - ofrohen vetëm tre programe konkurrençe sipas AKA				
7.3 Kolegji UBT kampusi në Lipjan - ofrohen disa programe jo konkurrençe sipas AKA				
7.4 Kolegji UBT kampusi në Gjilan – ofrohen disa programe jo konkurrençe sipas AKA				
8 KOLEGJI UNIVERSUM – PRISHTINË				
Programe nga fusha e biznesit	X	Programe nga fusha e juridikut	X	X
8.1. Kolegji Universum – Kampusi në Gjakovë – sipas AKA asnjë nga programet e akredituara nuk ofrohen në Gjakovë.				
8.2. Kolegji Universum – Kampusi në Ferizaj – ofrohen disa programe të ngjashme por jo konkurrençe për shkak të largësisë gjeografike				
9 KOLEGJI BIZNESI – PRISHTINË				
<i>Kolegji ofron programe të akredituara nga fusha ekonomike dhe juridike. Nuk organizohet në njësi akademike.</i>				
Programe nga fusha e ekonomisë	X	Programe nga fusha e juridikut	X	X
9.1 Kolegji Biznesi – dega në Gjakovë - sipas AKA nuk ofrohet asnjë nga programet e akredituara				
9.2 Kolegji Biznesi – dega në Prizren – sipas AKA ofrohet vetëm një program konkurrent				
10 KOLEGJI DARDANIA – PRISHTINË				
Nuk ka evidencë mbi njësitë akademike apo programet e akredituara. Nuk ka ende vendim të akreditimit institucional, sipas AKA-së.				
11 KOLEGJI ISPE – PRISHTINË				
<i>Kolegji ofron programe të akredituara nga fusha ekonomike dhe juridike. Nuk organizohet në njësi akademike.</i>				
Programe nga fusha e ekonomisë	X	Programe nga fusha juridike	X	X
11 KOLEGJI IBC-M – MITROVICË				
<i>Kolegji ofron programe të akredituara nga fusha ekonomike dhe juridike. Nuk organizohet në njësi akademike.</i>				
Programe nga fusha e ekonomisë		Programe nga fusha e juridikut	Programe nga fusha e agros	
12 KOLEGJI RIINVEST - PRISHTINË				
<i>Kolegji ofron programe të akredituara nga fusha ekonomike dhe juridike. Nuk organizohet në njësi akademike.</i>				
Programe ekonomike	X	X	X	X
13 Kolegji Pjeter Budi				
Programe ekonomike	X	X	X	X
14 Tempulli Academy				
X	X	X	X	X
15 RIT Kosovo (A.U.K) College				
Programe ekonomike	X	X	X	Programe nga fusha e arteve

Universiteti Haxhi Zeka

UHZ ka gjithsej 17 programe të akredituara, të cilat janë pjesë e 5 njësive akademike: Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i MTHM –së, Fakulteti Juridik, Fakulteti i Agrobiznesit dhe Fakulteti i Arteve - dega e muzikës. Si konkurrentë të drejtpërdrejt të UHZ konsiderohen të gjitha IAL (publike dhe private) që operojnë dhe ofrojnë studime / programe të ngjashme në regjionin e Dukagjinit, përkatësisht në qytetet: Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Ndërsa, në rrethin e gjerë si konkurrent mbetet Universiteti i Prishtinës si lider i arsimit të lartë në Kosovë. Prandaj, programet e studimit të UHZ-së do të krahasohen me UP dhe me institucionet tjera të arsimit të lartë që ofrojnë programe konkurrencte në rajonin e Dukagjinit.

UHZ në kuadër të planit strategjik 2022-2025 është përcaktuar për profilizim të programeve dhe të institucionit. Meqenëse Peja dhe rajoni i saj është e njohur për traditën në biznes, agrobiznes, art, kulturë dhe turizëm, UHZ ka orientuar programet e studimit në këtë drejtim në mënyrë që të jetë në gjendje t'u përgjigjet nevojave të tregut të punës. Përafrimi me tregun e punës dhe nevojat e saj është planifikuar të reflektohet në programet me orientim kah biznesi dhe ndërmarrësia, të cilat besohet se do ta përforcojnë pozitën e saj përballë rivalëve të tjerë publikë apo privatë, konkurrentë në arsim e lartë.

Universiteti “Hasan Prishtina”

Universiteti i Prishtinës i ka 14 fakultete, të gjitha me vendndodhje në Prishtinë. Programet e UP që janë të ngjashme dhe që potencialisht mund t'i bëjnë konkurrencë UHZ-së, jepen në vijim sipas katër fakulteteve homologe me UHZ. Edhe pse programet mund të jenë identike apo të ngjashme me ato të UHZ, nuk konsiderohet si konkurrencte e drejtpërdrejtë për shkak të largësisë gjeografike të Prishtinës nga Peja prej rreth (90 km). Sidoqoftë, për shkak të tendencës së mundshme të të rinjve për të studiuar në Prishtinë, një numër i të rinjve migrojnë nga qyteti i Pejës dhe nga rajoni i Dukagjinit. Sidoqoftë, nuk ka të dhëna për një numër të tillë të lëvizjeve brenda vendit për qëllime studimi.

Në përgjithësi, UP me programet e saj është një konkurrent për të gjitha IAL publike dhe private në tërë vendin për shkak të traditës, emrit, personelit me reputacion dhe vendndodhjes së njësive të saj akademike në Prishtinë si kryeqendër e Kosovës. Për të gjitha IAL-të që operojnë në rajonin e Prishtinës UP është një konkurrent i fortë për programet e njëjta apo të ngjashme. Në tabelën e mëposhtme, programet e UP-së që konsiderohen se kanë ndikim latent rivaliteti me programet e UHZ-së janë të shënuara me të kuqe për t'u dalluar (AKA, 2022). Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e sipërme identifikohen 12 programe, të cilat emërtohen ngjashëm / përafërt me ato të UHZ sipas njësive akademike. Përkatësisht, 3 në Fakultetin e Biznesit, 3 në Fakultetin e Agrobiznesit, 4 në Fakultetin e Arteve dhe 2 në Fakultetin Juridik. Gjersa, programet e Fakultetit të Turizmit, Hotelarisë dhe Mjedisit të UHZ-së nuk kanë fare konkurrencë, pasi që UP nuk ka programe të tilla. Kjo pikë është përparësi për UHZ-në. Një tjetër avantazh konkurrues për UHZ paraqesin programet në gjuhën boshnjake. Sidoqoftë, UP konsiderohet si një lider i IAL-ve në Kosovë për shkak të potencialit të lartë konkurrues, në radhë të parë për të gjitha IAL-të që operojnë në Prishtinë dhe regjion, e më pastaj edhe në tërë vendin.

Programet e UP që janë të ngjashme dhe që potencialisht mund t'i bëjnë konkurrencë UHZ-së, jepen në vijim sipas fakulteteve homologe me UHZ:

1. Fakulteti Ekonomik

- Menaxhment - baçellor;
- Menaxhment - master;
- Paraja, Banka, Financa dhe Sigurime – master;

2. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
 - Ekonomia e Bujqësisë - baçellor;
 - Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit - master;
 - Teknologji Ushqimore me Bioteknologji - baçellor;
3. Fakulteti i Arteve
 - Baçellor i Muzikës në Performim – baçellor në muzikë;
 - Master i Muzikës në Performim - master;
 - Baçellor i Muzikës;
 - Master i Muzikës në Edukim Muzikor - master;
4. Fakulteti Juridik
 - E Drejta Ndërkombëtare - LLM;
 - Juridik - LLB;

Universiteti “Isa Boletini” – Mitrovicë

Universiteti i Mitrovicës ka gjithsej 18 programe të akredituara, nga të cilat vetëm 2 janë të ngjashme me programet e UHZ. Kampusi universitar ka ndërtesa të reja, konvikt dhe hapësirë të mjaftueshme për studentë. Largësia gjeografike e Mitrovicës nga Peja është rreth 70 km. Prandaj programet e ngjashme me ato të UHZ nuk shihen me peshë konkurrionale. Konsiderohet se konkurrent i drejtpërdrejt i programeve të tij studimore është Kolegji IBCM dhe UP. Nga 18 programe sa ka gjithsej Universiteti i Mitrovicës, vetëm 2 programe janë të ngjashme me ato të UHZ-së, që të dyja në nivelin baçellor:

- E para, juridik i përgjithshëm dhe e dyta
- Biznes dhe Menaxhment.

Universiteti “Ukshin Hoti” – Prizren

Universiteti “Ukshin Hoti” me seli në Prizren ka gjashtë njësi akademike me 20 programe studimi, në nivelin baçellor dhe master. Disa nga programet janë në gjuhën boshnjake dhe turke. Prizreni gjendet në regjionin e Dukagjinit, përderisa largësia nga Peja është rreth 70 km. Nëntë programe janë të ngjashme ose të përafërta me programet studimore të UHZ, të shpërndara sipas fushës së studimit, në të dy nivelet e studimit. Katër nga këto programe janë të ngjashme me ato të Fakultetit të Biznesit, dy programe me ato të Fakultetit të Agrobiznesit, një me Fakultetin Juridik dhe një program i ngjashëm me atë të Fakultetit të Menaxhmentit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis, të cilat listohen si në vijim:

- Administrim Biznesi – baçellor;
- Administrim Biznesi – master;
- Juridik i Përgjithshëm – baçellor;
- Menaxhment Ndërkombëtar - baçellor;
- Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi - master;
- Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi - baçellor;
- Shkenca e Pyjeve dhe të Mjedisit-baçellor;
- Agrobiznes - baçellor;
- Menaxhim në Agrobiznes - master;

Që të dy universitetet, UHZ dhe UPZ përparësi kanë programet në gjuhën boshnjake në raport me IAL të tjera në regjionin e Dukagjinit. Programet e Fakultetit të Arteve paraqesin përparësi në relacion me universitetin e Prizrenit, pasi që ajo nuk ofron të tilla.

Kolegji AAB

Studimet në Kolegjin AAB zhvillohen në 14 fusha studimi të shpërndara nëpër fakultete përkatëse. Në kuadër të këtyre fakulteteve, veprimtarinë e vet e zhvillojnë 50 programe në nivelin baçellor dhe në nivelin master të studimeve. Përveç programeve të rregullta, ofrohen edhe programe për studentë pa shkëputje nga puna. Kolegji operon në 3 kampuse: Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë. Dega në Gjakovë është gjeografikisht më afër Pejës (36 km) dhe konsiderohet se është konkurrent i drejtëpërdrejt i UHZ. Në këtë degë organizohen studime në 2 programe të ngjashme me ato të UHZ-së, e të cilat konsiderohen me potencial të lartë rivaliteti, të cilat janë:

- Marketing dhe Administrim Biznesi – Dega Gjakovë / baçellor, me kuotë 80;
- Juridik i përgjithshëm – Dega Gjakovë / baçellor, me kuotë 80;

Nga programet e veçuara, përveç 2 programeve të identifikuara në degën e Gjakovës, ekzistojnë edhe 6 programe të ngjashme me programet e UHZ-së, të cilat organizohen në kampusin e Prishtinës. Megjithëse, potenciali konkurrues i këtyre programeve konsiderohet të jetë i lehtë për shkak të largësisë gjeografike, UHZ duhet të merr parasysh për të ndryshuar programet plotësisht identike, në mënyrë që të jenë në harmoni me planin strategjik për profilizim të programeve. Programet e ngjashme janë:

- Banka, Financa dhe Kontabilitet – baçellor;
- Menaxhment dhe Informatikë – baçellor;
- Banka dhe Financa – master;
- Marketing dhe menaxhim biznesi – master;
- Menaxhment – master;
- Kontabilitet dhe Auditim – master;

Përparësi evidente e UHZ është se Kolegji AAB nuk ka kampus në Pejë, nuk ofron studime në gjuhën boshnjake dhe aplikon tarifa të konsiderueshme për studentë. Megjithatë, ajo ofron 2 programe në degën e Gjakovës. Përparësi e Kolegjit është infrastruktura moderne, pajisjet digjitale dhe ambienti atraktiv për studentë.

Kolegji UBT

UBT aktualisht ka 53 programe të akredituara me rreth 150 specializime të ndryshme studimi, mbi 200 laboratorë të ndryshëm, poliklinikën, qendrat më të mëdha në rajon për teknologji dhe inovacion, qendrën 5G, qendrën e realitetit virtual dhe të shtuar, fabrikat e mençura, serat bujqësore, kopshtin botanik, infrastrukturën e modernizuar sportive e rekreative, kampuse në shumicën e qendrave kryesore në Kosovë, si dhe Hub-et më të mëdha teknologjike në Prishtinë dhe Prizren. Karakteristika këto që Kolegjin e bëjnë një rival të fortë për të gjitha IAL-të në Kosovë. Degët e saj në Pejë dhe në Prizren e bëjnë konkurrente të drejtëpërdrejtë me UHZ-në sa i përket programeve të ngjashme apo të përafërta studimi. Megjithatë, pjesa dërmuese e programeve janë nga kampusi kryesor i kolegjit, në Prishtinë (AKA, 2022). Dega e Kolegjit në Pejë, në nivelin baçellor organizon studime në dy programe:

- Administrim Biznesi – me kuotë regjistrimi 65;
- Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi – me kuotë regjistrimi 70;

Që të 2 këto programe, janë identike me programet / specializimet që ofron UHZ-ja në Fakultetin e Biznesit. Rrjedhimisht, programet me kuotë prej 135 studentë paraqesin konkurrencë të plotë. Megjithatë, përparësi e UHZ mbeten studimet pa pagesë, i cili fakt mund të josh studentët e përcaktuar për studim në programet përkatëse.

Dega në Prizren, po ashtu konsiderohet me potencial konkurrues. Në nivelin baçellor, ekzistojnë 4 programe të krahasueshme apo të ngjashme me ato të UHZ-së. Njëra nga to, e fushës së agrobiznesit përmban 4 specializime, të cilat janë:

- Shkencat e ushqimit dhe bioteknologjisë / specializimet:
 - a) Teknologjia e Ushqimit;

- b) Nutricion (Të ushqyerit);
- c) Menaxhimi dhe Sigurimi i Cilësisë të Ushqimit;
- d) Shkenca dhe Inxhiniera e Ushqimit;
- Inxhinieria e Agrokulturës dhe Mjedisit;
- Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi;
- Juridik i përgjithshëm;

Përveç 6 programeve të lartcekura nga degët në Pejë dhe në Prizren që identifikohen si të ngjashme me ato të UHZ-së, ekzistojnë edhe 6 programe të tjera të cilat janë të krahasueshme / mjaft të ngjashme me programet aktuale të UHZ-së. Këto programe organizohen në kampusin kryesor në Prishtinë, e të cilat jepen në vijim:

- Muzikë moderne, produksion digjital dhe menaxhment – master;
- Sisteme të Informacionit dhe menaxhment - baçellor dhe master;
- E drejta biznesore dhe evropiane - master;
- Shkencat e ushqimit dhe teknologjia – master;
- Bujqësia dhe inxhinieria e mjedisit - baçellor;
- Muzikë moderne, produksion digjital dhe menaxhim – baçellor;

Kampuset në Pejë dhe në Prizren të Kolegjit dhe programet e ngjashme paraqesin kërcënim serioz për UHZ-në. Dobësi e Kolegjit është se nuk ofron studime në gjuhën boshnjake dhe aplikon tarifa të konsiderueshme për studentë. Megjithatë, përparësi e Kolegjit është infrastruktura moderne dhe pajisjet digjitale për mësimdhënie.

Kolegji Universum

Sipas AKA, Kolegji ka gjithsej 16 programe të akredituara në nivelin baçellor me disa specializime. Dy nga programet janë të modelit “diplomë e dyfishtë”, 6 programe/specializime me diplomë nga universiteti Northampton dhe 5 programe profesionale nga niveli 3, 4 dhe 5 të KKK. Programi Biznes dhe Menaxhment, niveli baçellor është specifik sepse ofron 3 mundësi për studentët. Studime të zakonshme 3 vjeçare me diplomë të kolegjit, me diplomë të dyfishtë dhe me diplomë nga universiteti Northampton, Britani e madhe. Diploma e dyfishtë në Biznes dhe Menaxhment është program tre vjeçar i cili ofrohet bashkërisht nga Kolegji Universum në Kosovë dhe “Kajaani University of Applied Sciences” në Finlandë. Në kuadër të këtij programi studimet përfundojnë dy vite në Kolegjin Universum, dhe vazhdojnë vitin e tretë në “Kajaani University of Applied Sciences” në Finlandë. Nuk ka evidencë se cilat programe janë pjesë e cilës njësi akademike. Nga të gjitha programet e listuara më lartë, programi Biznes dhe Menaxhment dhe ai Juridik janë të ngjashme me programet që i ofron UHZ. Prandaj, konsiderohet se që të dy këto programe mund të jenë konkurrenca me programin Menaxhim Biznesi dhe atë Juridik i përgjithshëm të UHZ-së. Mirëpo, lokacioni i studimit të këtyre programeve është Prishtina, sipas të dhënave të AKA.

Distanca gjeografike që Peja ka me Prishtinën, bashkë me pagesën për studime që aplikojnë kolegjet private (nuk ka të dhëna mbi lartësinë e pagesës), çështja e konkurrencës direkte me UHZ konsiderohet se amortizohet mjaft shumë. Njëkohësisht, specifikat e lartcekura konsiderohen përparësi për UHZ. Avantazhe tjera konkurruese për UHZ janë se Kolegji Universum nuk ka kampus në Pejë, nuk ofron studime në gjuhën boshnjake dhe aplikon tarifa të konsiderueshme për studentë. Përparësi e Kolegjit është infrastruktura moderne, pajisjet digjitale dhe ndërtesat e reja dhe mjaft joshëse për studentë.

Kolegji “Biznesi”

Kolegji “Biznesi” është një tjetër institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë. Kolegji përveç selisë në Prishtinë ka edhe njësitë në Prizren, Gjakovë dhe Vushtrri ku zhvillohen studime në programet e akredituara në nivelin baçellor dhe master. Me disa nga programet e saj në degën e Gjakovës dhe Prizrenit trajtohet si konkurrente e UHZ nga pikëpamja gjeografike. Nga të dhënat e AKA-së është evidente se dega në Gjakovë nuk ka program të akredituar. Konkurrencë direkte mbetet dega e Prizrenit me programin Banka dhe Financa në Biznes në nivelin baçellor. Në përgjithësi, potenciali konkurrues i Kolegjit në raport me programet e UHZ duket se është mjaft i zbehtë, përkundër infrastrukturës moderne të saj. Konsiderohet, se UHZ ka përparësi për shkakun se vetëm një program i Kolegjit ofrohet në diametrimin e zonës së konkurrencës, që është regjioni i Dukagjinit.

Kolegji ICBM Mitrovicë

Kolegji ICBM është institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë me seli në Mitrovicë. Secili program ofron dy nivele të kualifikimit: Academy Profession (AP): 2 vite, ekuivalent me 120 ECTS kredi dhe Bachelor: 3.5 vite, ekuivalent me 210 ECTS kredi. Programe të ngjashme me UHZ janë identifikuar të jenë dy sish, nga të cilat njëra është e nivelit profesional dhe njëra e nivelit master.

- Menaxhimi i Mjedisit dhe Bujqësisë- BA;
- Teknologji dhe Informatikë e Aplikuar-BA;

Përparësi e Kolegjit janë programet e nivelit 5 të KKK, që njëkohësisht është dobësi për UHZ-në. Përparësi tjetër e Kolegjit është infrastruktura moderne dhe pajisjet digjitale për mësimdhënie. Dobësi e Kolegjit është se aplikon tarifa të larta për studime, njëjtë sikurse IAL-të private. Përparësi e UHZ janë programet nga fusha të ndryshme studimi.

Matrica e krahasueshmërisë së programeve

Tabela matricë e krahasueshmërisë së programeve të UHZ me programet e ngjashme që ofrohen nga institucionet rivale të arsimit të lartë në Kosovë jep një pasqyrë përmbledhëse mbi intensitetin e konkurrencës në mes tyre.

Tabela nr.4 Matrica e krahasimit

PROGRAMET E UHZ NË KRAHASIM ME PROGRAMET E IAL-ve									
Nr.	Programet studimore të UHZ	UP Prishtinë	UM Isa Boletini	UPZ Prizren	AAB	UBT	Universum	ICBM	Kolegji Biznesi
1	Business Management (BA)	YES	YES	YES	YES	YES	YES	NO	YES
2	Business Management (in Bosnian)	NO	NO	YES	NO	NO	NO	NO	NO
3	Business Management (MA)	YES	NO	YES	NO	YES	NO	NO	NO
4	Business Management (in Bosnian)	NO	NO	YES	NO	NO	NO	NO	NO
5	Human Resource Management	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO
6	Management in Tourism, Hospitality and Environment	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO
7	Management in Tourism (in Bosnian Language)	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO
8	International and European Law	YES	NO	YES	YES	YES	NO	NO	NO
9	Agro-environment and Agroecology	YES	NO	YES	NO	YES	NO	NO	NO

10	Food Technology	YES	NO	NO	NO	YES	NO	NO	NO
11	Plant Production Technology	YES	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO
12	Artistic Education in Performing	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO
13	Music Education (Baçellor)	YES	NO	NO	NO	YES	NO	NO	NO
14	Business Informatics	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO
15	Environmental Management	NO	NO	YES	NO	NO	NO	YES	NO
16	Sustainable Food Production Systems	YES	NO	NO	NO	YES	NO	NO	NO
17	Music Education (Master)	YES	NO	NO	NO	YES	NO	NO	NO

Burimi: autori, 2023

Rezultatet e studimit

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e sipërme mund të nxjerrën konstatimet vijuese: Pesë programe të akredituara të UHZ-së nuk kanë fare konkurrencë me IAL e krahasuara. Këto programe janë: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Menaxhimi në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis, Informatika në Biznes, Menaxhimi në Turizëm (gjuhë boshnjake) dhe Edukimi Artistik në Interpretim. Kjo rezulton të jetë kështu për shkak të krahasueshmërisë së emërimit dhe jo përmbajtjes së programit. Programet në gjuhën boshnjake duket se konkurrent të vetëm kanë Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren. Programet me konkurrencë të lehtë janë (1-2 konkurrentë): Teknologji Ushqimore, Teknologji e Prodhimit Bimor, Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, Menaxhimi i Mjedisit, Edukim Muzikor (BA dhe MA). Programet me konkurrencë mesatare (3-4 konkurrentë): Agromjedis dhe Agroekologji, E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane dhe Menaxhim Biznesi (MA). Programet me konkurrencë të lartë (5 e më shumë): Menaxhim Biznesi në nivelin baçellor është programi me intensitetin më të lartë të konkurrencës, pasi 7 nga 8 universitetet e krahasuara kanë program të ngjashëm apo të njëjtë.

Përfundim

Është evidente se universitetet dhe kolegjet private në arsimin e lartë në Kosovë ofrojnë programe pothuajse identike me njëra tjetrën. Kjo ka rezultuar me një situatë ku në mes të Bartësve të Arsimit të Lartë të mos ketë diversitet të qartë programor në bazë të burimeve natyrore, pozitës gjeografike dhe burimeve njerëzore ku ato veprojnë. Niveli i angazhimit në shkencë, mungesa e ideve novatore dhe ndërlihdja e programeve studimore me tregun e punës janë problemet kryesore të paraqitura në këtë punim. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar në shpejtësinë e ngopjes së tregut të punës, mungesës së profizilimit të studentëve për nevojat e reja të tregut dhe në dobësimin e rolit të këtyre institucioneve në përgjithësi. Kësaj situatë të pa favorshme, universitetet publike ene nuk iu janë përgjigjën në mënyrë adekuate, siç është profilizimi i programeve dhe institucionit.

Sot në fuqi është Ligji mbi parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit¹⁸ nga 03 shtator 2014. Shkaqet e miratimit të këtij ligji respektivisht për plotësimin e kësaj rregullative ligjore imponohet nevoja e harmonizimit me standardet ndërkombëtare- udhëzimet e parandalimit të shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit të vërtetuara nga ana e FATF-së me vitin 2012 dhe për tejkalimin e dobësive të vërtetuara në kornizën e rrethit të katërt të evaluimit nga ana e MONEYVAL- it, komitetit të Këshillit të Europës. Obligimet e parashtuara me këtë ligj subjektet i zbatojnë për qëllime të parandalimit të shpërlarjes së parave të ndërlidhura me indikacione të veprave penale dhe financimit të terrorizmit. Ligji i definon kuptimin dhe nocionet e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, ndërsa “ nocionin e nderlidh me veprën penale” është definuar si vepër penale që gjeneron të ardhura të cilat janë objekt i trajtimit të vepres penale e shpërlarjes së parave. Konform këtij ligji janë miratuar me shumë akte nënligjore ndër ta edhe:

1. Rregullorja për përmbajtjen e raporteve që dorëzohen deri te Drejtoria për parandalimin dhe larjen e parave dhe financimin e terrorizmit¹⁹.
2. Rregullorja për përmbajtjen dhe formën e të dhënave të cilat subjektet i dorëzojnë deri te Drejtoria për parandalimin dhe larjen e parave dhe financimin e terrorizmit dhe dorëzimin e tyre në formë elektronike²⁰.
3. Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e regjistrit numëruar të cilën e udhëheqin subjektet të cilët organizojnë punë këmbimi²¹.
4. Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e regjistrit numëruar të cilën e udhëheqin subjektet të cilët organizojnë lojrat e fatit nëpër kazino²².

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë Veriore (neni 273). Me nenin 273 të Kodit

Penal të Republikës së Maqedonisë Veriore²³, inkriminohet shpërlarja e parave dhe veprimet tjera si vepra penale. Shpërlarja e parave në legjislativën e RMV-së është e rregulluar në Ligjin Penal të vitit 1996, ndërsa në Kodin penal të vitit 2004 ka pësuar ndryshime rënjësore. Inkriminimi tërësisht është harmonizuar me rregullativën ndërkombëtare në vitin 2009 në drejtim të implementimit të Konventës së Vienës dhe Konventës së Palermos ku përfshihen të gjitha veprimet e lëshimit në qarkullim pranimin, ndërrimin, konverzimin, përcjelljen e të hollave si dhe shitjen, dhurimin, blerjen, pranimin e pengut ose lëshimin në qarkullim në forma të pronës ose lëndëve me qëllim që të fshihet burimi i vertete i tyre, lokacioni, lëvizja dhe pronësia.

Gjithashtu, ndryshimet e Kodit penal ridefinohen dhe caktohen nocionet të lidhura me këtë vepër penale. Me nocionin e të hollave nënkuptohen mjetet pagesore të gatshme në moneta ose të holla elektronike të cilat conform ligjit janë në qarkullim në R.M.V. dhe në diasporë. Nën nocionin e të hyrave nga veprat penale nënkuptohet çdo pasuri ose interes i fituar me ndërmjetësim ose drejtpërsëdrejti në ekzekutimin e veprës penale. Gjithashtu nën këtë nocion si të hyra nënkuptohet të hyrat si vepra penale të kryera në diasporë, me një kusht që të jetë inkriminim i dyfishtë (të jetë e paraparë në vend dhe jashtë si vepër penale në momentin e kryerjes si vepër penale).

¹⁶ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 04/08

¹⁷ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 57/10

¹⁸ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 130/14

¹⁹ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 38/09

²⁰ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 140/10

²¹ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 02/11

²² Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 02/11

²³ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 37/96

Nocioni i pronës perfshinë të hollat ose mjetet tjera të pagesës, letrat me vlerë, depozitin, pronësinë tjetër materiale ose jomateriale, sende të luajtshme ose të paluajtshme, të drejta të tjera ndaj lëndëve, ofertave si dhe dokumenteve publike dhe dokumenteve legale të pronësisë dhe aktivave në forma të shkruara ose elektronike ose instrumente me të cilat dëshmohet prona ose interesi i pronës si e tillë.

Ligji mbi policinë financiare. Neni 5 i Ligjit mbi policinë bashkëkohore²⁴ rregullon obligimet e policisë financiare si institucion që të mbledh informacione dhe të dhëna në bashkëpunim me organet tjera të ndjekjes me qëllim që të zbulohen shkelësit e ligjit që kanë qenë të kyçur në aktivitetet e shpërlarjes së parave, si dhe të zbatojnë hetuesinë për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një lloj i këtyre veprës penale nga personi i caktuar.

Ligji mbi Bankat. Sipas nenit 171 të Ligjit mbi Bankat²⁵ çdo bankë është e obliguar të veprojë konform rregullativës së parandalimit të shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Si supervisor në sistemin e parandalimit të shpërlarjes së parave paraqitet Banka Popullore e Maqedonisë Veriore.

Ligji i Procedurës Penale. Sipas nenit 142-b të Ligjit të Procedurës Penale²⁶ mund të zbatohen masa të veçanta të hetuesisë gjatë hetuesisë së veprave penale të kriminalitetit financiar siç është shpërlarja e parave. Gjithashtu sipas nenit 203-a mund të caktohet masa e sigurimit të përkohshëm të pronës ose mjeteve që kanë lidhje me veprën penale. Nën masa të sigurimit të përkohshëm të pronës ose mjeteve që kanë lidhje me veprën penale nënkuptohet ngrirja e përkohshme, konfiskimi, mbajtja e fondeve, llogaritë bankare dhe transaksionet financiare ose të hyrat e veprave penale që janë masa të zbatuara në raste të shpërlarjes së parave. Procedura që zhvillohet ndaj personave juridik është e përfshirë në këtë ligj dhe kanë pika të përbashkëta me veprat penale të shpërlarjes së parave kur si ekzekutues të tyre lajmërohen personat juridik.

Ligji i Prokurorisë publike. Neni 22 i Ligjit të prokurorisë publike²⁷ rregullon punët inter-personale në mes prokurorisë publike si organ i ndjekjes dhe institucionet tjera ndër ta edhe Policia financiare me qëllim të funksionimit të ndjekjes së veprave penale. Ndjekja e këtyre veprave penale të shpërlarjes së parave conform këtij ligji është nën kompetencën e Prokurorisë Themelore për ndjekjen e kryerësve nga sfera e kriminalitetit të organizuar dhe korrupsioni.

Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë Veriore, Konform nenit 32 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë Veriore²⁸, Banka Popullore e RMV-së zbaton supervizionin dhe kontrollin e punës së bankave dhe kursimoreve. Në raport me masat për rregullimin e kontrollit ndaj veprave penale të shpërlarjes së parave ky ligj nuk e ka atë rëndësi dhe peshë që e kishte ligji i mëhershëm.

Ligji i zbatimit të shërbimeve të shpejta në transferin e të hollave. Zhvillimet teknologjike kanë bërë revolucion edhe në sferën e transferimit të parave si mjete pagesore, prandaj sot në formë elektronike nëpërmjet transferit të shpejtë në afat prej një ore mund të dërgohen shumë e caktuar e parave nga një vend në vendin tjetër. Pavarësisht nga transferimi nga Republika e Maqedonisë Veriore ose nga jashtë hyrja dhe dalja e mjeteve behet nëpërmjet bankës Ligji i zbatimit të shërbimeve të shpejta në transferin e të hollave²⁹ rregullon mënyrën, licencimin, mbikqyrjen dhe sanksionimin e subjekteve të cilët kryejnë transferim të shpejt të parave. Këto subjekte janë të detyruara të përgatitin program për parandalimin e shpërlarjes së parave, të përgatitin raporte mujore për transaksionet e kryera deri te Banka Popullore të cilat e kryejnë revizionin dhe të respektohen të gjitha aktet që e rregullojnë parandalimin e shpërlarjes së parave, prandaj nëse nuk ndërmirren këto aktivitete mund të ndeshen me dënime me të holla.

Ky ligj është si rezultat i afrimit të rregullativës evropiane, rregullimi i kontrolleve adekuate ndaj subjekteve që vite me radhë miren me keto aktivitete financiare të transferit të shpejtë të parave si dhe përforcimi i konkurrencës jo lojale.

Ligji mbi punët devizore. Me këtë ligj rregullohet qarkullimi pagesor me vendet tjera, puna devizore e bankave, disponimi i devizave nga ana e qytetareve si dhe nxjerrja dhe futja Brenda e denarit, letra me vlerë devizore³⁰. Me vendim të Këshillit të Bankës Popullore të RMV-së³¹ janë përshkruar kushtet nën të cilën pagesa devizore dhe llogaritë e personave të huaj mund të kryhen me të holla efektive të huaja, si dhe obligimi që të paraqiten në BP të

²⁴ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 12/14

²⁵ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 67/07 dhe 90/09

²⁶ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 150/10

²⁷ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 150/07

²⁸ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 158/10

²⁹ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 77/03

³⁰ Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 34/01

³¹ Gazeta Zyrtare e RM –se nr.42/11

RMV-së për çdo pagesë jorezidente në bankë, kërkesa, deklarata për prejardhjen e mjeteve të personit të huaj, nëse bëhet fjalë për pagesa individuale me shumë më të larta se 10000 euro në kesh, si dhe mundësinë e kërimit të lejes nga BP të RMV-së për pagesa individuale për të hollat e huaja efektive me vlerë më shumë se 50000 euro.

Duke u bazuar në dispozitat e këtij ligji nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë Veriore është sjellur Vendim për kushtet lartësinë e vlerës së të hollave të huaja efektive dhe çeqe që mund të futen dhe nxjerren nga vendi³².

Përfundimi

Duke u bazuar në analizën e këtij punimi sa i përket aspektit krahasues të posedimit të infrastrukturës ligjore të dukurisë së shpërlarjes së parave, mundë të vijmë në përfundim se Republika e Kosovës ka arritur kënaqshëm të nxjerrë ligje të cilat dukurinë e shpërlarjes së parave e trajtojnë pothuajse njëjtë sikurse vendet e rajonit sa i përket mënyrës se kryerjes se kësaj veprë penale e cila është e sanksionuar edhe në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë se Veriut he në ligjin e posaçëm për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizimit. Ligjvënësi më rastin e aprovimit të Ligjit më për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizimit ka paraparë disa detaje të cilat i tejkalojnë edhe kërkesat e konventës së Vjenës dhe asaj të Palermos ku vepra penale e shpërlarjes së parave shtrihet edhe tek personat fizik të cilët me vetëdije angazhohen në veprimtari të shpërlarjes së parave dhe madje shkon përtej këtij kufiri. Elementi i dijes sipas nenit 273 i Kodit Penal është njohuria e kryerësit ("*kushdo që e ka ditur*") ose ka pasur bazë të arsyeshme për të ditur ("*ka pasur arsye për të ditur*") që pasuria që i nënshtrohet shpërlarjes përbën pasuri të fituar nga të ardhurat e krimit- dhe i vetmi detaj në rastin konkret që mendoj se duhet të rregullohet me rastin e amendamentimit të ligjeve të cilat e sanksionojnë këtë dukuri është koncepti terminologjik gjithnjë duke pas parasysh parimin e legalitetit në sistemin e drejtësisë penale. Në këtë këndvështrim krahasues Republika e Maqedonisë se Veriut ka arritur të krijoj mekanizma të rregullativës ligjore për parandalimin dhe luftimin e dukurisë së shpërlarës së parave. Por mjaftë sfidues mbetet bashkëpunimi i brendshëm i të gjithë këtyre mekanizmave dhe institucioneve të tjera sepse e gjithë aktiviteti i shpërlarës së parave në vendin tonë nuk mundë të identifikohet në bazë të memorandumëve të brendshme të disa institucioneve kompetente të cilat në radhë të parë kanë qasje indirekte në të dhënat e institucioneve kompetente, një gjë e tillë pra identifikimi më i lehtë i transaksionit të dyshimtë mundë të behët vetëm më aplikimin unik të sistemit të bazës së të dhënave në të gjitha institucionet relevante i cili sistem mendoj që duhet të jetë në gjuhën angleze edhe pse ky veprim kërkon amendamentim të Kushtetutës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare të Republikës së Republikës se Maqedonisë Veriore por më të vetmin qëllim rreth mundësisë më të shpejtë të ngrirjes së fondeve të cilat janë të dyshimta.

³² Gazeta Zyrtare e RM –se nr. 128/14

Literatura

- V. Kambovski, “Kazneno pravo – opsht del” 2-ri avgust, Shtip;
S. Buxhakoski. “ E drejta penale- pjesa e pergjithshme”, Kosta Abrash, Oher;
S. Buxhakoski. “ E drejta e procedures penale- pjesa e pergjithshme”⁹ ligjerata te autorizuar FON Univerzitet. Shkup.
N. Matovski, 2003, “ kazneno procesno pravo”, 2- ri avgust, Shtip;
S. Taseva, “Perenje Pari”, Data pons, 2003
G. Trajkovski, “Sprecurvanje na perenje pari kaj finansiskite institucii”, Akademski pecat, Skopje,2003

Dokumentet:

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nr 52/ 1991, Shkup;
2. Kodi Penal Gazeta zyrtare e R.M –se nr. 37, Shkup
3. Ligji i procedurës penale gazeta zyrtare e R.M-ss nr. 150/2010, Shkup
4. Ligji për parandalimin e shpsrlarjes ss parave, Gazeta zyrtare 70/2001, Shkup;
5. Ligji psr parandalimin e shpsrlarjes së parave dhe të hyrave tjera nga veprat penale, gazeta zyrtare nr. 46/2004, Shkup.
6. Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe kontributeve tjera dhe financimi i terrorizmit gazeta zyrtare nr. 130/2014, Shkup.
7. Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimi i terrorizmit. Gazeta zyrtare nr. 130/20, Shkup.
8. Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe kontributeve tjera dhe financimi i terrorizmit, Gazeta zyrtare nr. 04/2008, Shkup.
9. Ligji mbi Policinë financiare, Gazeta zyrtare e R.M-së, nr.12/2014;
10. Ligji mbi Prokurorinë publike, Gazeta zyrtare e R.M-së nr. 150/2007;
11. Ligji mbi Bankat, gazeta zyrtare e R.M-se nr. 67/2007 dhe 90/2009
12. Ligji mbi Bankën Popullore të RMV-së, gazeta zyrtare e R.M-së nr.158/2010;
13. Ligji mbi kryerjen e shërbimeve të shpejta transfer të parave, Gazeta zyrtare e R.M-së nr.77/2003;
14. Ligji mbi punët devizore, Gazeta zyrtare e R.M-se nr.34/2001

AFTËSITË TEKNIKE DHE NDËRPERSONALE NË APLIKIMIN E SISTEMEVE TË INOVACIONIT TEK BIZNESET ELEKTRONIKE

Autor: Prof. Ass. Dr. Hazir HAJDARI³³

& Prof. Ass. Dr. Besnik HAJDARI³⁴

E-mail: hazir.hajdari@kolegibiznesi.com; E-mail: besnik.hajdari@umib.net

ABSTRACT

Today, perhaps more than ever, the analysis of the interrelationships that exist between the consumer, the enterprise, and the society constitutes the basis of success, therefore marketing is the main essence for the success of an enterprise. While working on this topic, I elaborated on important information that helps raise awareness and knowledge about marketing, and the importance it has for building a company's success. During this topic, you will have the opportunity to gain knowledge about marketing as a concept, the importance of marketing in raising the success of a company, and the types of marketing. Electronic marketing is of great importance, which is mostly used by companies for the sale of production machinery, and it is the main essence for achieving success since the customer is also informed about the products offered by the company. Nowadays, technology has almost reached the peak of accessibility, and now even the customer can be informed about the products and prices offered in the market.

Keywords: internet, advertising, legal business, businesses, consumer, sale.

ABSTRAKT

Sot ndoshta më tepër se kurrë analiza e lidhjeve të ndërsjellta që ekzistojnë midis konsumatorit, ndërmarrjes, shoqërisë përbën bazën e suksesit, prandaj edhe marketingu është thelbi kryesor për suksesin e një ndërmarrjeje. Gjatë punimit të kësaj teme kam shtjelluar informacione të rëndësishme të cilat ndihmojnë në ngritjen e vetëdijes dhe njohurive për marketingun, dhe rëndësinë që ka për ndërtimin e suksesit të një kompanie. Gjatë kësaj teme do të keni mundësi të përfitoni njohuri për marketingun si koncept, rëndësinë e marketingut në ngritjen e suksesit të një firme, llojet e marketingut. Rëndësi të madhe ka marketingu elektronik, i cili përdoret më së shumti nga firmat për shitjen e makinerive prodhuese, e që është thelbi kryesor për arritjen e suksesit, pasi edhe klienti është i informuar për produktet që ofron firma. Në ditët e sotme teknologjia ka arritur pothuajse kulmin e arritshmerisë, dhe tashmë edhe klienti mund të jetë i informuar për produktet dhe çmimet që ofrohen në treg .

Keywords: internet, advertising, legal business, businesses, consumer, sale.

Hyrje

Mbi të gjitha mund të themi se marketingu është një mjet, por një mjet kritik për të tërhequr klientë të rinj, për të tërhequr vëmendjen e tyre në produktet dhe shërbimet e një ndërmarrjeje si dhe për të ndërtuar themelet e marrëdhënieve që do të zgjasin. Marketingu ndihmon në vendosjen e avantazhit konkurrues dhe si rezultat të rrisni shitjet.

³³ Fakulteti I Shkencave Kompjuterike, Kolegji BIZNESI, Prishtine - Kosove

³⁴ Fakulteti I Inxhinierise Mekanike dhe Kompjuterike, Universiteti "Isa Boletini" Mitrovce - Kosove

Marketingu është një aspekt thelbësor i biznesit tuaj i cili kërkon hulumtime të shumta, kërkon kohë, nevojitet planifikim dhe kërkojnë alokime të mjeteve financiare.

Si koncept marketingu është një filozofi, qasja juaj ndaj marketingut do të paracakttojë teknikat tuaja të shitjes, kështu që komunikimi dhe bashkëpunimi brenda ekipit tuaj është kritik. Marketingu nuk është një punë e cila mund të bëhet vetëm, secili në ekipin tuaj duhet të ketë përgjegjësitë e caktuar për kampanjat e caktuara.

Për shkak se sukcesi i marketingut është i mbështetur tërësisht në tërheqjen e vëmendjes së konsumatorit dhe ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata, atëherë që nga shërbyesi i vijës së parë e deri tek shërbyesi i fundit duhet të jenë të vetëdijshëm për kampanjën si dhe të kuptojnë rolin dhe përgjegjësinë përgjatë gjithë kohës së kampanjës.

Marketingu përdor platformat e komunikimit dhe reklamimit për të bindur klientët që marka juaj, përfshirë produktet dhe shërbimet tuaja, janë pikërisht ato që u nevojiten. Mirëpo, çështja është se ju duhet të përfshini çdo aspekt të strategjisë tuaj të marketingut, dhe jo vetëm reklamimin e produktit, ju si ekip duhet të përqendrohni në plotësimin e nevojave aktuale dhe ato të ardhshme të klientit. Nëse klienti ka ardhur pasi ka dëgjuar për kampanjën e juaj dhe më vonë është kthyer i zhgënjyer tërësisht për shkak të shërbimit të dobët nga stafi juaj, atëherë jo vetëm se ju ka shkuar huq investimi por keni krijuar disa klientë të pakënaqur në të njëjtën kohë

Konceptet zbatuese dhe aplikimi i biznesit elektronik

Definimi i biznesit elektronik - Shprehjen “Biznes Elektronik”, e përdori për herë të parë kompania “IBM” në vitin 1997 me qëllim që të bëhej dallimi në mes të shprehjes “tregti elektronike”.

Biznesi elektronik - paraqet afarizmin në të cilin transaksionet ekonomike realizohen në mënyrë elektronike dhe njihet me emrin afarizëm elektronik ose biznes elektronik, i cili realizohet me ndihmën e teknologjisë informatike dhe të internetit.

Autori Panian - thotë se biznesi elektronik është forma bashkëkohore e organizimit, e cila në masë të madhe varet nga përdorimi i teknologjisë informatike dhe mbështetja e sistemeve informatike.

Spremic - thotë se shprehja biznes elektronik paraqet një koncept gjithëpërfshirës, përmes të cilit lidhen dhe digjitalizohen të gjitha aktivitetet afariste që nga zhvillimi i produkteve e deri te menaxhmenti dhe administrata.

Nga aspekti i komunikimit - biznesi elektronik nënkupton dërgimin e informatave, produkteve, shërbimeve të pagesave përmes telefonit ose rrjetave kompjuterike etj.

Nga aspekti i afarizmit - biznesi elektronik nënkupton përdorimin e teknologjisë digjitale në proceset e automatizuara afariste.³⁵

³⁵ Banka dhe afarizem bankar –Dr Gazmend Luboteni, Prishtinë 2013

Nga aspekti i shërbimeve - biznesi elektronik paraqet një vegël, e cila shfrytëzuesve të shërbimeve u siguron të dhëna më të shpejta lidhur me ofertën e produkteve dhe shërbimeve.

Nga aspekti i perspektivës online - biznesi elektronik siguron mundësinë e blerjes dhe shitjes së produkteve dhe informatave përmes internetit dhe serviseve tjera online.

Arsyet e aplikimit të biznesit elektronik në kompanitë në ekonominë e diturisë janë:

- Shfrytëzimi sa më i mirë i resurseve afariste në dispozicion,
- Sigurimin e pozitës më të mirë konkurruese në treg,
- Dëshira për rezultate sa më të mira afarise dhe financiare etj.

Profesionet që janë ndërlidhur me biznesin elektronik si formë e afarizmit bashkëkohor janë:

- konsulent tregtar,
- zhvillues i aplikacioneve,
- broker,
- web-dizajner,
- menaxher i prodhimit,
- programer etj.

4.1. Fazat e ndikimit të internetit në zhvillimin e biznesit elektronik

Broshurat elektronike përfshijnë periudhën 1993 - 1996, kur për herë të parë u krijuan ëeb- faqet dhe u mundësua publikimi në distancë i informatave lidhur me ndërmarrjen, andaj ndërmarrjet e kishin kuptuar se duhet t'i ndajnë dokumentet e ndryshme me klientë, furnizues dhe partnerë afaristë, duke përdorur postën elektronike ose FTP. 2.

Biznesi elektronik filloi në vitin 1996, kur kompania Amazon.com filloi të sjellë në internet industrinë e librave elektronikë, duke mundësuar prezantimin e katalogjeve dhe broshurave në mënyrë elektronike, kryerjen e pagesave etj, dhe është modë e biznesit një shitës me shumë shitës ose një me shumë.

Prokurimi elektronik filloi në vitin 1998 me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve indirekte zyrtare, të cilat ishin të larta. Prokurimi elektronik është model i biznesit shumë me shumë.

Tregu elektronik filloi në vitin 2000 dhe paraqet një vend ku zhvillohet tregtia me ndonjë produkt ose shërbim apo kryhet ndonjë transaksion afarist dhe është model i biznesit me shumë shitës me shumë blerës.

Ekosistemet dinamike paraqesin bashkëpunimin e disa tregjeve industriale, ku ndërmarrjet veprojnë direkt njëra me tjetrën pa ndërmjetësimin e serverit qëndror.

Mënyrat e transformimit të biznesit klasik në biznes elektronik

Teknologjia e internetit dhe biznesi elektronik mund të aplikohen në sisteme afariste në shumë mënyra, dhe transformimi i afarizmit nga afarizmi klasik në afarizëm elektronik mund të bëhet në disa mënyra. Ato janë:

Përparimi i procesit elektronik - paraqet një proces, i cili nënkupton përmirësimin e procesit afarist ekzistues. Këtu kemi të bëjmë me një proces transformues stabil me të cilin kompania nuk i nënshtrohet ndonjë rreziku të madh, por ka për qëllim të përcillen ndryshimet në treg dhe rrethinën afariste të informatizuar.

Riinxhinieringu i procesit afarist - nënkupton një qasje sistematike me qëllim të ndryshimit rrënjësor të proceseve kryesore afariste në organizatë, si dhe përkrahjen e proceseve afariste bazë. Riinxhinieringu i procesit afarist ka të bëjë me ridefinimin dhe ridizajnimin rrënjësor të procesit afarist në një organizatë, i cili nuk ka për qëllim vetëm modifikimin dhe ndërmarrjen e veprimeve parciale në riorganizimin e proceseve ekzistuese afariste, por parasëgjithash nënkupton përmirësimin e parametrave kyç të afarizmit siç janë: shpenzimet, kreativiteti, shpejtësia etj.

Riinxhinieringu i procesit nënkupton - Ndryshime bazike rrënjësore në aktivitete afariste, sjell ndryshime kualitative në procesin afarist dhe orientohet në procese dhe aktivitete të cilat synojnë shndërrimin e madhësive hyrëse në madhësi dalëse.

Inovacioni i modelit afarist paraqet një metodë të riinxhinieringut të procesit afarist, e cila është e lidhur ngushtë me strategjinë e afarizmit. Përmes këtij koncepti, synohet të arrihen suksese në transformimin e atyre proceseve afariste në organizatë, të cilat nuk kanë dhënë rezultate me aplikimin e teknikave të përmendura të afarizmit klasik.

Aplikacionet kyçe për zhvillimin e biznesit në mënyrë elektronike:

Posta me zë - është një sistem i cili digjitalizon porosinë e dhëna me zë dhe i transmeton ato nëpër rrjeta duke i vendosur në disqe për lexim të mëvonshëm. **Fax makina** - mundëson dërgimin e teksteve dhe paraqitjeve grafike përmes linjës telefonike, ku makina bën skanimin e dokumentit duke mundësuar digjitalizim e tij.

Telekonferencat - ofrojnë mundësinë në pjesëmarrjen në diskutim përmes linjës telefonike ose softverit të postës elektronike për komunikim në grup.

Data konferencat - ofrojnë mundësinë që dy ose më shumë individë në lokacione të ndryshme të punojnë në dokumentin e njëjtë ose të përdorin të dhëna të njëjta.

Videokonferencat - paraqesin telekonferencat në të cilat pjesëmarrësit e shohin njëri-tjetrin përmes ekranit.

4.2 Këmbimi elektronik i të dhënave

Këmbimi elektronik definohet si këmbim i të dhënave të strukturuar ndërmjet kompjuterëve të sistemeve informatike të kompanive në mënyrë elektronike pa ndërhyrje manuale dhe me ndihmën e standardeve në forma të definuara më parë.

Sipas autorëve Bocij, Chaffey, Greasley dhe Hickie - këmbimi elektronik i të dhënave nënkupton këmbimin e të dhënave të strukturuar në mënyrë elektronike midis kompjuterëve të dy apo më shumë ndërmarrjeve, me qëllim të kryerjes së transaksioneve afariste siç janë: dokumentet, faturat, llogaritë etj. Këmbimi elektronik i të dhënave mund të bëhet nëse posedojnë me standarde të cilat i mundësojnë transportimin e të dhënave nga dërguesi te marrës, me softver i cili bën të mundur konverzionin dhe përmes medimeve komunikuese për transmetimin e porosisë nëpërmjet rrjetit publik dhe privat.

Infrastruktura e biznesit elektronik

Nënkupton sigurimin e parakushteve teknologjike dhe predispozitive ligjore. Infrastruktura teknologjike përfshinë serverët, klientët dhe rrjetin sistemor dhe operativ, ndërsa predispozitat ligjore kanë bërë të mundur zhvillimin pa pengesë të biznesit elektronik.

Përparësitë e biznesit elektronik

Arsyeshmëria ekonomike - paraqet mundësitë e biznesit elektronik, i cili krijon forcë të afarizmit bashkëkohor për rritjen e shansave të qëndrueshmërisë në treg, respektivisht lidhjen elektronike të pjesëve të ndërmarrjes dhe integrimin e jashtëm me partnerë afaristë.

Arsyeshmëria teknologjike - ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë informatike dhe komunikuese për digjitalizimin e medimeve të ndryshme siç janë zëri, teksti, fotografia. Sipas Turban, ndërmarrjet nga biznesi elektronik sigurojnë shpenzime të ulëta administrative, shpenzime të ulëta të krijimit, mbledhjes, përpunimit, mundësinë e zvogëlimit të produkteve të gatshme etj.

Konsumatorët- nga biznesi elektronik kanë përparësi: plotësimin e nevojave të tyre në çdo kohë 24/7, të zgjedhin prodhuesin, produktin, ndërmjetësuesit etj. **Shoqëria** - nga biznesi elektronik ka dobi në zhvillimin virtual të afarizmit, ulë çmimin e produkteve dhe shërbimeve, mundëson mësim në distancë etj.

Rreziqet e biznesit elektronik janë - humbjet fizike për shkak të mashtrimeve, përgjimi, infiltrimi në sistem, ndryshimi i të dhënave, përdorimi i paautorizuar i resurseve, tejkalimi i autorizimeve, refuzimi i ofrimit të shërbimeve, humbja e punës për shkak të problemeve me server, rreziku nga virusët etj.

Siguria e biznesit elektronik - nënkupton kombinimin e teknologjisë, të masave dhe veprimeve të cilat duhet të ndërmerren për të mbrojtur të dhënat dhe informatat nga qasja e paautorizuar.

Kriptografia - paraqet shifrimin e porosisë së kuptueshme në porosi të pakuptueshme dhe bëhet me ndihmën e çelësit dhe të mekanizmit për shifrim. Çelësi mund të jetë publik dhe i fshehtë.

Deshifrimi - paraqet procesin e kundërt me shifrimin, pra paraqet një funksion matematikor, përmes të cilit transformohet porosia e shifruar më parë.

Autenticiteti - nënkupton vërtetimin e identitetit me të cilin paraqitet shfrytëzuesi. Kjo arrihet përmes PIN-it, fjalës kaluese etj.

Integriteti i të dhënave - nënkupton mbrojtjen e të dhënave ose instalimin e serverit të sigurisë, i cili shfrytëzon protokolet për siguri të të dhënave SSL.

Format e biznesit elektronik janë:

- tregtia elektronike,
- marketingu elektronik,
- qeverisja elektronike,
- afarizmi bankar elektronik etj.

Shpërndarja elektronike e diturisë dhe shërbimeve bëhet përmes principit online, ku shfrytëzuesi kyqet në ëeb-faqe të ndonjë institucioni arsimor dhe zhvillon interaksion për përvetësimin e programit arsimor, ndërsa shpërndarja e shërbimeve elektronike ka të bëjë me intervenimin online në programet e instaluara në kompjuterin e shfrytëzuesit të lidhur në internet.

Rezervimet elektronike- Rezervimet elektronike paraqesin një formë të biznesit elektronik, e cila u mundëson klientëve të bëjnë rezervime në hotele apo agjensi turistike.

4.3 Përparësitë dhe të metat e tregtisë elektronike

Përparësitë:

- Sigurohet evidencë e plotë dhe e saktë e të gjitha produkteve dhe çmimeve furnizuese
- Zvogëlohen shpenzimet e afarizmit dhe rritet efikasiteti dhe fleksibiliteti i punës.
- Sigurohet qasja e shpejtë në informata etj.

Të metat:

- Vështirësitë për të gjetur persona me përvojë,
- Rreziku i mashtrimeve dhe keqpërdorimeve,

- Shpenzimet e larta të marketingut,
- Mundësitë për vjedhjen e identitetit të blerësve etj.

Nga aspekti ekonomik, rreziqet e tregtisë elektronike janë: humbjet direkte financiare si pasojë e mashtrimeve, humbja e informatave të vlefshme dhe të besueshme, humbja e punëve për shkak të pamundësisë për qasje në servis, përdorimi i paautorizuar i resurseve etj.

Masat mbrojtëse të tregtisë elektronike kanë për qëllim:

- Identifikimin, autentifikimin dhe autorizimin e shfrytëzuesit,
- Mbrojtjen e internetit nga qasja e shfrytëzuesve të paautorizuar,
- Mbrojtjen me antivirus,
- Mbrojtjen e fshehtësisë së të dhënave,

4.4 Llojet e tregjeve elektronike

Kemi këto lloje të tregjeve elektronike :

Tregje elektronike horizontale - të cilat i lidhin pjesëmarrësit nga industritë e ndryshme të cilat janë të specializuara për kryerjen e ndonjë funksioni afarist dhe atë ia ofrojnë veprimtarive tjera.

Tregjet elektronike vertikale - janë ato tregje, të cilat lidhin blerësit, shitësit dhe ndërmjetësuesit dhe pjesëmarrësit tjerë në transaksionet afariste në kuadër të veprimtarisë së njëjtë.

Tregjet elektronike të krijuara nga blerësit - janë tregje me qëllim të organizimit të mirë të blerjes dhe të distribuimit të produkteve nga furnizuesit tek blerësit nëpërmjet internetit.

Tregjet elektronike të krijuara nga furnizuesit - janë tregje me qëllim të organizimit më të mirë të shitjes dhe të distribuimit të produkteve deri te blerësi.

Tregjet elektronike të pavarura, të cilat janë të organizuara nga ndërmjetësuesit e organizatave të pavarura me qëllim të realizimit të tregtisë, e cila realizohet nëpërmjet blerësve dhe shitësve.

Ndërmjetësuesit elektronik - nënkuptojnë një model të tregut, ku konsumatorët bëjnë kërkesat e tyre, kurse ndërmjetësuesit hulumtojnë oferta nga furnizuesit dhe zgjedhin ofertën e cila i përshtatet më së miri konsumatorit.

Bursat elektronike - paraqesin vendet ku bëhet blerja dhe shitja e ndonjë të mire materiale. Ekzistojnë bursat e mallërave, parave, gurëve të çmueshëm,

ndërsa bursat më të mëdha botërore janë: Bursa e Tokios, Londrës dhe Neë York-ut.

Përfundimi

Nga punimi i kesaj teme vijmë në përfundim se ndërmarrja përdor marketingun si platformë e komunikimit dhe reklamimit për të bindur klientët që marka saj, përfshirë produktet dhe shërbimet, janë pikërisht ato që u nevojiten. Mirëpo, çështja është se ju duhet të përfshini çdo aspekt të strategjisë tuaj të marketingut dhe jo vetëm reklamimin e produktit, ju si ekip duhet të përqendrohemi në plotësimin e nevojave aktuale dhe ato të ardhshme të klientit. Nëse klienti ka ardhur pasi ka dëgjuar për kampanjën e juaj dhe më vonë është kthyer i zhgënjyer tërësisht për shkak të shërbimit të dobët nga stafi juaj.

Të reklamojmë aktivitetin tonë në internet, do të thotë të identifikohemi më shpejtë dhe më shumë, do të thotë të jemi më të suksesshëm se të tjerët, do të thotë të renditemi më lartë se të tjerët në motorët kryesor të kërkimit, do të thotë të kemi një trafik më të madh vizitorësh, duke i përmbledhur të gjitha në një fjali të vetme; do të thotë që kemi gjetur portën e cila na mundëson një publicitet në masë të gjerë.

Stop reklamave marrëzishtë të shtrenjëta nëpër TV dhe Radio, tani kemi mundësinë të paguajmë më lirë dhe të arrijmë një sukses më të shpejtë. Interneti gjithmonë e më shumë po bëhet rruga kryesore e çdo aktiviteti dhe biznesi në botë.

Kompanitë kosovare duhet patjetër të bëhen pjesë e këtij komuniteti të gjerë, të përfshihen në erën e re të virtualizimit dhe teknologjisë bashkëkohore. Tani nuk është më e vështirë të hapim një biznes dhe të reklamojmë atë me sa më pak shpenzime dhe të jetë sa më fitimprurës. Nëpërmjet tij, mund të blejmë, të shesim, të tregtojmë dhe të konkurrojmë me firmat të tjera. Forma më e re dhe më e ndershme për një biznes më të sigurtë dhe të suksesshëm padyshim që sot është Marketingu Elektronik.

Rekomandime

- Një metodë e lirë dhe e gjerë e komunikimit është posta elektronike. Është një medium i lehtë dhe i qëndrueshëm. Përdoret për të dërguar mesazhe për t'u bashkuar me njerëzit duke përdorur emra dhe adresa të listuara tashmë. Ka qenë një mjet komunikimi gjithnjë në rritje brenda organizatës.
- Marketingu në internet mund të përdoret gjithashtu në një situatë tjetër - inovacionet e produktivitetit.
- Përdorimi i mediumit elektronik duhet të ndihmoj personelin e shitjeve, dhe të përshpejtojë përgjigjet në pyetjet e konsumatorit në lidhje me të dhënat e produktit, nivelet e aksioneve etj.
- Praktika e marketingut dhe shitjeve në internet do të jetë më e dobishme për marrëdhëniet biznes me biznes në të ardhmen e menjëhershme.
- Duhet të arrihet siguri më e lartë gjatë tregtisë elektronike dhe të menjahen të gjitha rreziqet.
- Sjellja e blerjes së konsumatorëve duhet të gjurmohet nga kompanitë, për të cilat krijohen baza të të dhënave në thellësi.
- Një tjetër kusht biznesi ku mund të shfrytëzohet marketing online është planifikimi i marketingut dhe mbështetja e shitjeve. Është e mundur që njerëz shtesë të përdorin këtë ndërmjetës për informacionin reklamues.

Konkluzione

- Marketingu është një disiplinë relativisht e re që është shfaqur në fillim të viteve 1900
- Komunikimi është sferë e jetës së njeriut, që ekziston pothuajse, që prej ekzistimit të vetë jetës. Komunikimi bëhet me mjete dhe forma të ndryshme, ku një ndër format më bashkëkohore të komunikimit është rrjeti global që ndryshe e quajmë INTERNET.
- Ndër shërbimet kryesore të internetit, që përdoret nga bizneset është marketingu elektronik ku me këtë nënkuptojmë reklamimin e produkteve dhe shërbimeve përmes kompjuterit.
- Në këtë punim ne kemi folur për format më të lehta dhe më të përdorura për reklamim në internet si dhe përparësitë e kësaj forme të reklamimit ndaj formave tjera të reklamimit, si në mediat e shkruara dhe ato televizive.
- Marketingu përmes internetit, ndryshe E-marketingu është marketimi i produkteve ose shërbimeve nëpërmjet internetit, i cili sjell përfitime të shumta dhe unike për marketingun, duke përfshirë koston e ulët në distribuimin e informacioneve dhe me këtë luan rolin e një mediumi ndaj audiencës globale.
- Forma më e re dhe më e ndershme për një biznes më të sigurtë dhe të suksesshëm padyshim që sot është Marketingu Elektronik.
- Interneti është një mundësi e shkëlqyeshme për bizneset që të informojnë klientët potencial për mallrat dhe shërbimet e tyre. Mënyra më efektive e përfitimit të informacioneve tek konsumatori është të kemi një web.

Literatura

- [1] Marketingu –Bardhyl ceku- Nail Reshidi
- [2] Biznesi elektronik – Dr Mihane Berisha
- [3] Adam, S., Mulye, R., Deans, K. and Palihawadana, D. (2002) “E-marketing in perspective: a three-country comparison of business use of the Internet”
- [4] Kotler, 1999 Marketing Management
- [5] Nexhmi Rexha, Bazat e Marketingut
- [6] Banka dhe afarizmi bankar –Prof. Dr. Gazmend Luboteni, Prishtinë 2013

Materiali nga internet:

<https://www.ukessays.com/essays/marketing/importance-of-electronic-marketing-in-business-today-marketing-essay>

www.wikipedia.com

<https://www.slideshare.net/fatonbajrami1/biznesi-elektronik-dr-mihane-berisha-skript>

https://www.researchgate.net/publication/299619197_Biznesi_elektronik_Ligjerata_te_authorized

https://www.academia.edu/14825346/Marketingu_elektronik_si_mjet_i_komunikimit_me_konsumatorin

**THE BANKING SECTOR AND PAYMENT SERVICES AS A FACTOR IN THE
COMPANY'S SUCCESS**
**BANKARSKI SEKTOR I USLUGE PLAĆANJA KAO FAKTOR USPJEŠNOSTI
PREDUZEĆA**

Prof.ass.dr.Hajrija Skrijelj¹, Dr.sc.Sami Mazreku², Dr.sc.Duda Balje³

(¹University "Haxhi Zeka" , ²College Tempulli, ³College AAB)

Abstract

During the last two decades, the world financial market has a continuous trend of growth and interconnection. Banks, as an important segment of the financial market, were not immune to these processes. The battle for higher profits in banking has turned into a battle for the client, of course a satisfied client. Thus, realized profit and client satisfaction became two sides of the same coin. Without satisfied clients there is no realized profit, just as without profit there are no satisfied clients. All this spoke in favor of the development of the quality of services.

Looking throughout the history of banking, banks paid very little attention to marketing. The very appearance of the banks, which were built like Greek temples, inspired awe. The interior of the banks exuded coldness and conservatism, imposing certain codes of banking behavior. All employees were always very restrained, serious and measured in their actions.

The development of banking in Kosovo has characteristics that are partly expressed in the specifics of the development of banking in countries with a market economy, and partly in the characteristics of the evolution of banking in countries in transition. Historical reasons, socio-political and socio-economic circumstances reflected both the general state of the socio-economic environment and changes in the banking sphere. The characteristics of today's banking system are: strengthening of competition, increased concentration, dominance of foreign banks (already established), reduction of interest rates (causes: competition, reduction of systemic risk). The banking sector remains the most powerful intermediary that enables domestic and foreign sources of funds to be directed towards the economy and citizens

Keywords

The characteristics of today's banking system are: strengthening of competition, increased concentration, dominance of foreign banks.

Abstract

Tokom posljednje dvije decenije, svjetsko finansijsko tržište ima kontinuirani trend rasta i međusobne povezanosti. Banke kao bitan segment finansijskog tržišta, nisu bile imune na date procese. Bitka za veći profit u bankarstvu se pretvorila u bitku za klijenta, naravno zadovoljnog klijenta. Tako su ostvareni profit i satisfakcija klijenata postali dvije strane jedne iste medalje. Bez zadovoljnih klijenata nema ostvarenog profita, kao što i bez profita nema zadovoljnih klijenata. Sve ovo je govorilo u prilog razvoja kvaliteta usluga.

Gledano kroz istoriju bankarstva, banke su veoma malo, posvećivale pažnju marketingu. Sam izgled banaka, koje su bile građene kao grčki hramovi, je ulivao strahopoštovanje. Unutrašnjost banaka je odisala hladnoćom i konzervativnošću, namećući određene kodekse bankarskog ponašanja. Svi zaposleni su uvijek bili veoma uzdržani, ozbiljni i veoma odmjereni u svojim postupcima.

Razvoj bankarstva na Kosovu ima karakteristike koje se djelimično izražavaju u specifičnostima razvoja bankarstva u zemljama tržišne ekonomije, a djelimično u karakteristikama evolucije bankarstva zemalja u tranziciji. Istorijski razlozi, društveno-političke i društveno-ekonomske okolnosti odrazili su se kako na opšte stanje društveno-ekonomskog okruženja, tako i na promjene u sferi bankarstva. Karakteristike bankarskog sistema današnjice su: jačanje konkurencije, povećana koncentracija, dominacija stranih banaka (već uspostavljena), smanjenje kamata (uzroci: konkurencija, smanjenje sistemskog rizika). Bankarski sektor ostaje najsnažniji posrednik koji omogućava usmjeravanje domaćih i stranih izvora sredstava ka privredi i građanima. U današnjem turbulentnom okruženju, gotovo je nemoguće zamisliti uspjeh i izgradnju imidža banke bez konstantnog povećanja kvaliteta usluge u njenom poslovanju. Da bi opstale, kao takve, banke su bile prinuđene da nastupaju na tržištu sa inovativnim idejama za poboljšanje svoje pozicije među oštrom konkurencijom.

Sve veći značaj kvaliteta usluge u bankarstvu uslovlilo je jačanje konkurentne borbe za klijente, porast nivoa finansijskog obrazovanja klijenata i skokovit razvoj i primjena bankarske tehnologije.

Banke kao finansijske i uslužne organizacije nisu do skora posjedovale sklonosti ka usvajanju marketing koncepta. Pošto potrošač predstavlja ključni faktor poslovanja i najvrijedniju imovinu banke, njegova satisfakcija predstavlja najvažniji zadatak banke. Neophodnost razvijanja i ulaganja u kvalitet usluge ima za glavni cilj povećanje obima i kvaliteta tražnje za proizvodima i uslugama, kao i stvaranje lojalnih korisnika.

Kroz ovaj rad će se prikazati uloga i uticaj kvaliteta usluge na povećanje konkurentnosti banke. Stvaranjem imidža banka razvija u svijesti korisnika imidž o sebi kao velikoj, uspješnoj i prijateljskoj banci, i na taj način povećava svoj obim poslovanja a samim tim i svoj profit. Velike banke će naročito voditi računa o društvenoj odgovornosti, i dosta će ulagati u PR. Direktni marketing dobijaće na značaju (baze podataka klijenata, direktan kontakt i ponuda raznih usluga). Sve više pažnje posvetiće se sistemu usluživanja, uslužnom ambijentu i samom uslužnom personalu (lični bankari, personalizacija..). Paralelno će za specifičan segment biti razvijane i usluge elektronskog bankarstva i plaćanja.

Na prelazu u novi vjek, banke su služile uglavnom samo za primanje plate i podizanje čekova. Danas je standard viši, a potrebe izuzetne, te se širi i paleta usluga banaka, koja se mora približiti potrošačima na adekvatan način. Prikazivanje proizvoda ne smije biti glavni cilj promotivne aktivnosti, već prikazivanje koristi za privredu i građane.

Savremena i moderna bankarska institucija mora da ima jasno definisan odnos prema promotivnim akcijama. Smisao promotivne aktivnosti je da služi direktno i istovremeno kao podsjetnik i klijentima s jedne strane i prodajnom operativnom osoblju banke s druge strane u cilju povećanja prodaje proizvoda i usluga banke. Promotivna aktivnost banke ispoljava se kroz: lične napore aranžera bankarskih usluga, napore kontaktnog osoblja sa komitentima i klijentima i komunikacione programe sa masama.

Pojam i definisanje usluge

Riječ kvalitet često se pominje kako u poslovanju, tako i u svakodnevnom životu. To je pojam **sa vrlo kompleksnim sadržajem. Uvažavajući postojeću literaturu i potrebe prakse, moglo bi se dati sledeće tumačenje pojma kvaliteta. On, prije svega, označava samo svojstvo, osobinu ili karakter. Često citirana definicija kvaliteta je: „Kvalitet je mjerilo, u kojem proizvod ispunjava zahtjeve kupca”. U svom osnovnom značenju,**

kvalitet se definisao kao „usaglašenost sa zahtjevima". Ovo podrazumjeva da organizacija mora utvrditi zahtjeve i specifikacije; kada su jednom utvrđene, cilj kvaliteta različitih funkcija organizacije je udovoljiti striktno ovim specifikacijama. Druga grupa definicija ističe da je kvalitet sve u vezi sa „prilagođenošću za upotrebu", definicija koja se primarno zasniva na zadovoljenju potreba kupaca. Ove dvije definicije se mogu ujediniti u koncept kvaliteta koji uočava kupac - kvalitet može biti definisan samo od kupaca i događa se gdje organizacija obezbeđuje robu i usluge za specifikaciju koja zadovoljava njihove potrebe.

Kvalitet se različito definiše kao „prilagođenost za upotrebu", „usaglašenost sa zahtjevima", „stepen u kojem proizvod ispunjava zahtjeve kupaca" i „oslobodenost od varijacija". Američko društvo za kontrolu kvaliteta (ASQC) i Američki institut za nacionalne standarde (ANSI) definišu kvalitet kao ukupnost svojstava i karakteristika proizvoda ili usluge koji utiču na njihovu sposobnost da zadovolje iskazane ili implicitne potrebe. To je definicija kvaliteta koja je jasno usmjerena ka kupcima. Ona sugerise da preduzeće nudi kvalitet kad god njegov proizvod podmiruje ili nadmašuje potrebe, zahtjeve i očekivanja kupaca. Preduzeće koje zadovoljava većinu potreba svojih kupaca u većini slučajeva je preduzeće kvaliteta.

U zavisnosti od polaznih osnova može se razlikovati nekoliko pristupa definisanja kvaliteta. Prema jednom shvatanju moguće je identifikovati sljedećih pet pristupa:

- Transcendentni pristup i definicija kvaliteta;
- Proizvodno-zasnovane definicije;
- Definicije zasnovane na korisniku;
- Procesno-zasnovane definicije;
- Vrijednosno zasnovane definicije.

Transcendentan pristup definiciji polazi od pretpostavke da se radi o nenadmašnoj usluzi – mjeri savršenstva. Ovo je vidljivo samo kroz iskustva sa uslugom. Ovakav pristup primjenljiv je naročito u igranim i vizuelnim oblicima umjetnosti.

Zahtjeva ponovljena izlaganja usluge potrošačima. Sa stanovišta menadžera ne pomaže puno konstatacija o kvalitetu usluge nakon što je usluga korišćena, jer tada može biti prekasno ukoliko je potrošač nezadovoljan.

Proizvodno-zasnovane definicije su precizne i mjerljive definicije. Razlika u kvalitetu je posljedica različitih sastojaka ili atributa iz kojih se proizvod sastoji. Ovdje se dakle radi o objektivnoj kategoriji mjerenja, primjenljivoj kod fizički opipljivih dobara, gdje ukus, potrebe ili preferencije potrošača nemaju uticaja na viđenje kvaliteta.

